

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5931
E premte, 15 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Regjisorja Arzana Kraja
përcillet për në
banesën e fundit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FIKRIM DAMKA | FAQE 4-5

DO TË KËRKOJMË POSTE MINISTRORE PËR T'U BËRË PJESË E QEVERISË

Kryetari i ri i Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP), Fikrim Damka, ka treguar se kjo parti do të kërkojë poste ministrore për t'u bërë pjesë e qeverisë së re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se me marrjen e përgjegjësi në qeverinë e re do të bëjnë punë produktive ashtu siç kanë bërë edhe në qeveritë e kaluara. Damka ka bërë me dije se kërkesë tjetër e kësaj partie për mandatarin e ri do të jetë përfaqësimi më i mirë i komunitetit turk në institucionet e Kosovës. Si kryetar i ri i kësaj partie ai është zotuar se do të angazhohet për zgjidhjen e problemeve të komunitetit turk në Kosovë



OPINION

GJEOPOLITIKË: BALLKANI
PERËNDIMOR PAS
REFUZIMIT NGA BE-ja F. 08

Prof. Dr.
Blerim REKA



AKTUALE

POLICIA SHKATËRRON RRETH
600 ARMË TË SHKURTRA TË
LEHTA F. 3

RRITET NUMRI I TË SËMURËVE
ME DIABET F. 5

800 MIJË EURO PAJISJE TË
REJA PËR SALLAT OPERATIVE NË
QKUK DHE KATËR SPITALE F. 7

EKONOMI

'NEWCO FERRONIKELI' REAGON
RRETH ZHVILLIMEVE TË FUNDIT
NË FABRIKË F. 9

PUNËTORËT E SEKTORIT PRIVAT
NË JAVËN TJETËR PROTESTOJNË
F. 9

SPORT

KOSOVA HUMBET NGA ÇEKIA,
EVROPIANIN E KËRKON NGA
LIGA E KOMBEVE F. 9



Supremja: Votat nga Serbia të largohen nga rezultati i zgjedhjeve të 6 tetorit

Gjykata Supreme ka vendosur që votat e ardhura nga Serbia të largohen nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 6 tetorit, duke refuzuar kështu ankesën e dy kandidatëve për deputetë të LV-së, një të LDK-së dhe të disa kandidatëve për deputetë nga partitë e minoriteteve. Me këtë vendim koalicioni Nisma-AKR-PDK bëhet pjesë e Kuvendit të Kosovës me gjashtë deputetë. Udhëheqësit e këtij koalicioni kanë vlerësuar se Gjykata Supreme me këtë vendim ka treguar se në Kosovë funksionon shteti ligjor



Peter Beyer
emërohet
raportues për
Kosovën në
Këshillin e
Evropës



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama: Shengeni ballkanik për qytetarët, jo për politikanët

TRANË, 14 NËNTOR - Kryeministri Edi Rama deklaroi se marrëveshja për Shengenin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor iu vlen në radhë të parë njerëzve të thjeshtë, atyre që doganat dhe barrierat mes shteteve i detyrojnë të humbin orë të tëra në radhë, duke pritur për të kaluar anën tjetër të kufirit. Përmes një video-mesazhi, kryeministri Rama shprehet se

"Shengeni rajonal është për qytetarët dhe njerëzit e punës, jo për politikanët që nuk presin në radhë askund".

Kjo është mbështetur edhe nga vetë zëri i qytetarëve, të cilët pohojnë se këto barrierat doganore janë vërtet të tepërta. "Kjo barrierë është e tepërt. Dogana është e tepërt", shprehet një qytetar. "Çdo ditë presim një orë," thotë një tjetër qytetar, i cili

ndodhet në radhë, në pritje të kalimit të kufirit doganor. "Minimumi dy orë, dy orë e gjysmë, ndoshta më tepër," shprehet një tjetër qytetar.

Sipas kryeministrit Rama, marrëveshja e Ballkanit Perëndimor do t'iu japë fund njëherë e mirë pritjeve të gjata në dogana dhe do krijojë liri lëvizjeje pa barrierat për njerëzit, mallrat, shërbimet e kapitalet.



Peter Beyer emërohet raportues i Këshillit të Evropës për Kosovën

Deputeti i Bundestagut gjerman, Peter Beyer, të enjten është zgjedhur raportues për Kosovën në Këshillin e Evropës, duke mposhtur në këtë garë ish-spiunin rus, Aleksey Kondratyev. Beyer njihet për qëndrimet e tij kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Deputeti i Bundestagut gjerman, Peter Beyer, është zgjedhur raportues për Kosovën në Këshillin e Evropës.

Beyer në këtë garë ka mposhtur ish-spiunin rus, Aleksey Kondratyev.

Gjatë votimit të enjten në Komitetin për Politikë të Jashtme dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Beyer ka fituar 33 vota, kurse rusi Kondratyev ka marrë vetëm 6 vota.

Vendimi për zgjedhjen e raportuesit për Kosovën në KE do të kalojë edhe nëpër mekanizma të tjera të këtij Këshilli, por që votimi i sotëm llogaritet si më i rëndësishmi.

Në Kosovë kandidatura e të dërguarit rus në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Aleksei Kondratyev, për këtë post kishte nxitur debate të ashpra.

Lideri në Kosovë kishin paralajmëruar se do të refuzonin çdo bashkëpunim me të nëse do të zgjidhej, ndërsa mbi 40 organizata të shoqërisë civile në Kosovë i

bënë thirrje Asamblesë Parlamentare dhe Komitetit për Çështje Politike që të mos e bëjnë një gjë të tillë. Reagimet kundër kandidatit rus iu referuan njoftimeve të pakonfirmuara të medieve lokale se ai ishte përfshirë në një incident në Kosovë në vitin 2001, kur shërbente si pjesë e kontingjentit rus në kuadër të forcave paqeruajtëse ndërkombëtare.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore evropiane që për të drejtat e njeriut në kontinent dhe përbëhet nga 47 vende anëtare.

Raportuesi i ri për Kosovën, Peter Beyer është deputet i parlamentit gjerman nga radhët e demokristianëve të kancelares Angela Merkel.

Ai njihet për qëndrimet e tij kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës dhe ka bërë thirrje më herët gjatë këtij viti që Bashkimi Evropian të emërojë një të dërguar të posaçëm për bisedimet Kosovë - Serbi, pak pasi që Shtetet e Bashkuara emëruan Matthew Palmer si përfaqësues të posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor.



Emërimi i tij është mirëpritur në Kosovë. Kryeministri në largim Ramush Haradinaj, uroi që "ky vendim të jetë një rifillim i mbarë i angazhimit evropian në Kosovë, me qëllim të avancimit të rrugëtimit të Kosovës drejt integritetit të plotë në familjen evropiane". Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj e cilësoi lajm "fantastik" emërimin e Beyer.

"Gjermania është partneri më i rëndësishëm strategjik dhe mbështetës i madh i Republikës së Kosovës për anëtarësimin e saj në organizata ndërkombëtare. Kosova e ka dëshmuar dhe do ta dëshmojë se është bartëse e të

drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike", ka shkruar Hoxhaj. Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës por ka statusin e vëzhguesit në Asamblesë parlamentare të tij.

Peter Beyer vjen nga partia e kancelares Merkel, CDU. Ai ka lindur më 25 dhjetor të vitit 1970 dhe është i specializuar në fushën e drejtësisë. Përveç dy universiteteve në Gjermani, Beyer gjithashtu në vitin 2001 ka magjistruar në Universitetin e Virginias në fushën e Drejtësisë. Në vitin 2009, Beyer është zgjedhur deputet në Bundestagun gjerman, ndërkohë që nga prilli 2018,

shërben si koordinator transatlantik për bashkëpunim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme në qeverinë e kancelares Merkel.

Beyer është një prej deputetëve gjermani i cili e viziton më së shpeshti Kosovën. Është fuqishëm kundër korrigjimit të kufijve si ide për arritjen e një zgjidhje finale të problemit shumë vjeçar Prishtinë-Beograd. Ndërkohë në vizitën e fundit në Prishtinë, nga zyrat e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Beyer kishte thënë se liberalizimi i vizave mund të jetë një dhuratë e Krishtlindjeve për kosovarët.

Zgjedhjet presidenciale në Kroaci, më 22 dhjetor

ZAGREB, 14 NËNTOR - Kryeministri Andrej Plenković ka njoftuar se Kroacia do t'i mbajë zgjedhjet presidenciale muajin e ardhshëm.

Zgjedhjet e 22 dhjetorit do ta nxjerrin presidenten aktuale, Kolinda Grabar-Kitarović, kandidat e Unionit Demokratik të Kroacisë, në garë kundër kandidatit të Social-Demokratëve dhe ish-kryeministrit Zoran

Milanović.

Dy kandidatë të pavarur gjithashtu kanë mbështetje në sondazhe.

Pozita presidenciale është kryesisht ceremoniale në Kroaci.

Presidenti nuk mund t'iu vë veto ligjeve, por ka rol në politikën e jashtme dhe mbrojtje.

Sipas sondazheve të fundit, Garbar-Kitarović është favorite

për t'iu fituar zgjedhjet me rreth 29 për qind të votave, ndërsa Milanović do të jetë i dyti me 24 për qind.

Në garë do të jenë edhe Miroslav Skoro, këngëtar, dhe ish-gjykatësi Mislav Kolakushiq. Nëse asnjëri nuk e fiton shumicën në rrethin e parë të zgjedhjeve, rrethi i dytë do të zhvillohet më 5 janar të vitit 2020.



Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka refuzuar ankesat e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe disa partive të minoriteteve

Supremja: Votat nga Serbia të largohen nga rezultati i zgjedhjeve të 6 tetorit

Gjykata Supreme ka vendosur që votat e ardhura nga Serbia të largohen nga rezultati përfundimtar i zgjedhjeve të 6 tetorit, duke refuzuar kështu ankesën e dy kandidatëve për deputetë të LV-së, një të LDK-së dhe të disa kandidatëve për deputetë nga partitë e minoriteteve. Me këtë vendim koalicioni Nisma-AKR-PDK bëhet pjesë e Kuvendit të Kosovës me gjashtë deputetë. Udhëheqësit e këtij koalicioni kanë vlerësuar se Gjykata Supreme me këtë vendim ka treguar se në Kosovë funksionon shteti ligjor



EPOKA ERE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Gjykata Supreme ka vendosur të enjten që mbi 3 700 pako me fletëvotime të ardhura nga Serbia mos të jenë pjesë e rezultati përfundimtar të zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme ka refuzuar ankesat e dy kandidatëve për deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje, një të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ankesat e disa kandidatëve për deputetë të minoriteteve, të cilët kishin ankimuar vendimin e PZAP-it që e urdhëronte KQZ-në për heqjen nga rezultati përfundimtar të votave të ardhura nga Serbia. "Gjykata Supreme brenda afatit ligjor ka shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me të gjitha ankesat e pranuar nga deputetë të subjekteve politike. Gjykata Supreme ka pranuar shtatë ankesa të deputetëve nga subjekte të ndryshme politike. Pas shqyrtimit nga ana e Kolegjit ankesa nga deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

është refuzuar, ankesa nga deputetë të Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) është refuzuar, ankesa nga deputetë të Partisë Liberale Egjiptiane (PLE) është refuzuar, dy ankesa nga deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) janë refuzuar, ankesa nga deputetë të Partisë Demokratike të Ashkalinjve (PDA) është refuzuar dhe ankesa nga deputetë të Progresivna Demokratska Stranka (PDS) është hedhur poshtë si e palejuar", është thënë në njoftimin e Gjykatës Supreme.

Me këtë vendim të Supremes, koalicioni Nisma-AKR-PD përfundimisht bëhet pjesë e Kuvendit të Kosovës. Liderët politikë të këtij koalicioni kanë përshëndetur vendimin e Gjykatës Supreme, duke e vlerësuar se ky institucion mbrojti ligjshmërinë në vend. "Vendimi i Gjykatës Supreme është fitore e ligjshmërisë. Ky vendim sikur ai i PZAP-së mbrojti integritetin e zgjedhjeve të cenuara nga veprimet e paligjshme. Gjykata Supreme dhe PZAP-i me këto

vendime treguan se shteti ligjor këtu funksionon dhe institucionet e këtij shteti ligjor janë gardiane për mbrojtje të ligjit dhe demokracisë në Kosovë dhe se ato kanë integritet të lartë profesional e shtetëror dhe nuk lejuan asnjë interferim nga jashtë, por në mënyrë strikte e kthyen ligjshmërinë në këtë proces, i cili ishte sfiduar seriozisht nga njerëz të papërgjegjshëm, që për përfitime të tyre ishin të gatshëm ta dëmtojnë procesin më të rëndësishëm në një shtet ligjor, siç janë zgjedhjet e lira", ka shkruar Limaj në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka vlerësuar se pas këtij vendimi në dy shkallët më asnjëherë nuk mund që persona të papërgjegjshëm ta grabisin e deformatojnë vullnetin e qyte-

tarëve në mënyrë të paligjshme. "Sot ka fituar Kosova e gjithë atyre që duan ta shohin një shtet funksional, ligjor e demokratik, që nuk bën kompromise të ndyra në dëm të ligjit, rrjedhimisht edhe në dëm të shtetit ligjor. Andaj, shfrytëzoj rastin që në emër të Nismës dhe partnerëve të koalicionit dhe me tepër se 42 mijë votuesve të koalicionit tonë, t'u shpreh mirënjohje, respekt dhe konsideratë më të lartë të gjithë gjyqtarëve profesionistë të cilët kanë marrë këtë vendim dy herë", është shprehur Limaj. Kurse presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka deklaruar se Supremja i hodhi poshtë fletushkat nga Serbia që dikush deshë t'i kontrabandojë si vota. "Drejhtësia u vendos. Fletushkat nga Serbia, që dikush deshë t'i

kontrabandojë si vota, u hodhën poshtë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook". Pas vendimit të Supremes, koalicioni Nisma-AKR-PD do të jetë i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës me gjashtë deputetë. Ndërkohë, të mërkurën pasdite në Kosovë ka nisur rinumërimi i fletëvotimeve të mbi 1 400 vendvotimeve nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 6 tetorit.

Organizatrat që monitorojnë procesin zgjedhor kanë thënë se ky proces mund të zgjasë deri në tri javë. Rinumërimin e votave e ka urdhëruar Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) bazuar në ankesat e partive politike ndaj rezultati përfundimtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Policia shkatërron rreth 600 armë të shkurtra të lehta

Të gjitha armët dhe municioni i akumuluar iu përkasin llojeve të ndryshme, përderisa shkatërrimi i tyre është bërë me urdhëresë të organeve të drejtësisë, pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat e parapara ligjore

EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Policia e Kosovës, nën mbështetjen dhe përkrahjen e UNDP-së, ka shkatërruar një sasi të armëve të shkurtra dhe të gjata të cilat janë konfiskuar gjatë realizimit të detyrave dhe hetimeve policore. Procesit të shkatërrimit të armëve i ka paraprirë një konferencë në të cilën kanë marrë pjesë, zëvendësministri i MPB-së, Izmi Zeka,

zëvendës drejtori i PK-së Samedin Mehmeti, Maria Suokko nga UNDP-ja dhe Hakan Ejderk nga Zyra e BE-së, të cilët vlerësuan se shkatërrimi i armëve të paligjshme përbën një element të rëndësishëm të kontrollit të armëve në Kosovë si një metodë efektive për reduktimin e numrit aktual të armëve në tregun e paligjshëm e që reflekton në ngritjen e nivelit të sigurisë.

Të gjitha armët dhe municioni i akumuluar iu përkasin llojeve të



ndryshme, përderisa shkatërrimi i tyre është bërë me urdhëresë të organeve të drejtësisë, pasi kanë përfunduar të gjitha procedurat e parapara ligjore.

Në krahasim me metodat e tjera në dispozicion, të tilla si shitje ose dhuratë, shkatërrimi siguron se armët nuk do ta gjejnë rrugën e tyre (përsëri) në tregun e paligjshëm dhe në këtë mënyrë mund të ndërtohet besim në përpjekjet e përgjithshme për ta parandaluar, luftuar dhe çrrënjësuar tregtinë e tyre të paligjshme. Shkatërrimi i këtyre armëve mund të llogaritet edhe si një aktivitet shtesë i realizuar në kuadër të Strategjisë të Kosovës për Kontrollin e Armëve për Zvogëlimin e Rrezikut nga Armët e Zjarrit dhe Eksplozivët.

Flet për "Epokën e re", Fikrim Damka

Do të kërkojmë poste ministrore



Kryetari i ri i Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP), Fikrim Damka, ka treguar se kjo parti do të kërkojë poste ministrore për t'u bërë pjesë e qeverisë së re. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se me marrjen e përgjegjësisë në qeverinë e re do të bëjnë punë produktive ashtu siç kanë bërë edhe në qeveritë e kaluara. Damka ka bërë me dije se kërkesë tjetër e kësaj partie për mandatarin e ri do të jetë përfaqësimi më i mirë i komunitetit turk në institucionet e Kosovës. Si kryetar i ri i kësaj partie ai është zotuar se do të angazhohet për zgjidhjen e problemeve të komunitetit turk në Kosovë

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike Turke të Kosovës (KDTP), Fikrim Damka, ka thënë se për t'u bërë pjesë e koalicionit të ardhshëm qeverisës kjo parti do të kërkojë poste ministrore. Ai ka treguar se kjo parti në Kuvendin e Kosovës përfaqësohet me dy deputetë dhe i takon një ministri. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Damka ka deklaruar se me marrjen e përgjegjësisë të reja në qeverinë e re do të bëjnë punë produktive ashtu siç kanë bërë edhe në qeveritë e kaluara. "Në qeverinë e re si me deputetë nga komuniteti turk, sigurisht do të

kërkojmë detyra ministrore. Unë besoj që si komuniteti turk kemi bërë punë të lëndueshme në qeveritë e kaluara. Do të bëjmë punë edhe më të mira në qeverinë e re", ka thënë ai. I pari i KDTP-së ka përmendur edhe kërkesat e tjera të kësaj partie që do t'i ketë ndaj mandatarit për formimin e qeverisë. "Një nga kërkesat tona do të jetë që të kemi më shumë përfaqësim të komunitetit turk në institucionet e Kosovës, duke mos dhënë kushte për krijim e qeverisë", është shprehur ai. Damka si kryetar i ri i kësaj partie ka folur edhe për procesin e brendshëm partiak që e ka bërë shef të KDTP-së. Ai është zotuar se do të angazhohet për

për t'u bërë pjesë e qeverisë



një herë të gjithë delegatët që më kanë zgjedhur kryetar të partisë. KDTP-ja është partia e vetme që përfaqëson komunitetin turk në Kosovë. Kështu që detyrat tona kryesore janë: të interesohemi për problemet në komunitetin turk në Kosovë, t'i krijojmë zgjidhjet për problemet sidomos në arsim dhe në kulturë. Gjithashtu, punësimi i të rinjve nga komuniteti turk është një nga përparësitë tonë.

"Epoka e re": Për një kohë të gjatë në krye të kësaj parti ka qenë z. Mahir Jaghillar. Sa sfiduese do të jetë për ju ta zëvendësoni një lider që ka drejtuar këtë parti që nga paslufta?

Damka: Z. Mahir Jaghillar për një kohë të gjatë ishte kryetar i

partisë dhe ka dhënë kontribut për komunitetin turk dhe tërë Kosovën. Ky është një ndryshim i flamurit dhe ne do të përpiqemi ta ngremë atë më lart se sa ai ku u la. Si deputet i cili deri më tani kam vepruar si përfaqësues i partisë për tri mandate në Kuvendin e Kosovës, jam plotësisht i sigurt, bashkë me ekipin tim, se do të jemi në gjendje ta vazhdojmë agjendën e re në këtë periudhë.

"Epoka e re": Sa jeni i kënaqur me rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit?

Damka: Rezultatet e zgjedhjeve më 6 tetor janë shembulli më i dukshëm i nevojës për ndryshim në tërë Kosovën. Dua të them se kemi pësuar ulje të votave sa i përket KDTP-së dhe

nuk jam kënaqur me rezultatet e zgjedhjeve, por besoj se do t'i analizojmë mirë këto rezultate të zgjedhjeve dhe do ta rrisim këtë në zgjedhjet lokale.

"Epoka e re": Zyrtarët e kësaj partie janë takuar me fituesin e zgjedhjeve, z. Albin Kurti. A do të kërkonte ndonjë ministri për t'u bërë pjesë e qeverisë së re?

Damka: Në qeverinë e re me dy deputetë nga komuniteti turk sigurisht do të kërkojmë detyra ministrore. Unë besoj që si komuniteti turk kemi bërë punë të lëndueshme në qeveritë e kaluara. Do të bëjmë punë edhe më të mira në qeverinë e re. Një nga kërkesat tona do të jetë që të kemi më shumë përfaqësim të komunitetit turk në institucionet e Kosovës.

Rritet numri i të sëmurëve me diabet

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Dita Botërore e Diabetit është shënuar edhe në Kosovë në kuadër të përpjekjeve përsensibilizimit rreth diagnostikimit dhe trajtimit të kësaj sëmundjeje. Diabeti konsiderohet sëmundje kronike që karakterizohet me rritjen e nivelit të sheqerit në gjak si pasojë e çrregullimit të prodhimit të insulinës në organizëm. Ndonëse nuk ka statistika të sakta, të raportuar janë më shumë se 13 mijë persona që vuajnë nga kjo sëmundje.

Diabeti tip1 konsiderohet më problematik dhe numri i pacientëve që vuajnë nga ky tip i sëmundjes është rreth 10 për qind e numrit total të të sëmurëve me diabet si dhe është fazë më e avancuar krahasuar me tipat e tjerë të kësaj sëmundjeje. Një nga to është Pranvera Hajdari, e cila thotë se, krahas sfidës që ka me diabetin tip1, përballat edhe me mungesë të kohëpaskohshme të terapisë.

Edhe kur institucionet publike shëndetësore janë të furnizuara me terapi dhe material përcjellës, sipas saj, ato janë barna të tipave të vjetruar tashmë, që në shumë vende të botës nuk përdoren pasi që janë zëvendësuar me barna të tjera. "Para tre vjetësh jam diagnostikuar me diabet. Edhe babin dhe gjyshen i kam me diabet. Insulina është në listën esenciale, por shpesh nuk gjendet dhe duhet të presim në radhë. Do të ishte mirë që institucionet të kenë kujdes më të madh për këtë kategori të të sëmurëve. Po e them këtë pasi që terapitë që përdoren këtu janë të ndryshme me ato që përdoren në botë. Këtu përdoren

terapi me insulinë që injektohen drejtpërdrejt në trup, kurse në shtetet e tjera përdoren terapi të reja, ndryshe nga tonat", thotë ajo.

Endokrinologët në vend thonë se për kategorinë e pacientëve me diabet tip1 do të duhej të sigurohen pompat e insulinës të cilat imitojnë mënyrën e sekretimit të insulinës nga pankreasi. Këto pompa të insulinës shërbejnë për marrjen e insulinës në sasi precize. Përmes saj mundësohet arritja e vlerës mesatare të sheqerit në gjak për tre muaj. Pompa është ideale dhe e ulë rrezikun e paraqitjes së hipo apo hiperglikemisë si dhe parandalon shfaqjen e komplikimeve nga diabeti.

Rina Tafarshiku, endokrinologe në Klinikën e Endokrinologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, thotë se diabeti ka shënuar rritje nga viti në vit. Ajo pohon se pacientët e varur nga insulina analoge dhe humane ende detyrohen t'i blejnë shiritat për glikemi. "Në QKUK ende s'bëhet një analizë. Pacientët, edhe pse kanë insulina analoge dhe humane, ende

detyrohen t'i blejnë shiritat për glikemi. Vetëm muajin e kaluar kanë qenë 623 pacientë me diabet, 402 me diabet tip2. Vitin e kaluar janë hospitalizuar 612 pacientë me diabet tip2, prej tyre 370 femra dhe 242 meshkuj", bën të ditur ajo.

Ndërkaq Sergey Karyak, shef i Zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) në Prishtinë, bëri të ditur se në botë janë më shumë se 400 milionë persona të prekur nga diabeti. Ai tha se në shtetet e varfra kjo sëmundje është më shumë e pranishme.

Sëmundja e sheqerit prek edhe fëmijët. Aktualisht në Kosovë nuk ka statistika të sakta as për fëmijët që vuajnë nga diabeti, por profesionistët shëndetësorë thonë se numri i tyre është çdo vit në rritje. Në krahasimet afatgjata, thuhet nga profesionistët të fushës, se përderisa në vitin 2007 numri i fëmijëve që ishin diagnostikuar me diabet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës ka qenë 12 raste, në tre vjetët e fundit janë shfaqur nga rreth 50 raste të reja në vit me diabet. Këta fëmijë janë të varur nga insulina. (REL)



zgjidhjen e të gjitha problemeve të komunitetit turk në Kosovë. "Falënderoj edhe një herë të gjithë delegatët që më kanë zgjedhur mua kryetar të partisë. KDTP-ja është partia e vetme që përfaqëson komunitetin turk në Kosovë. Kështu që detyrat tona kryesore janë: të interesohemi për problemet në komunitetin turk në Kosovë, t'i krijojmë zgjidhjet për problemet, sidomos në arsim dhe në kulturë. Gjithashtu, punësimi i të rinjve nga komuniteti turk është një nga përparësitë tonë", ka thënë Damka. Ai nuk është shprehur i kënaqur me rezultatin që kjo parti ka arritur në zgjedhjet e parakohshme të 6 tetorit. Damka është zotuar se do të

angazhohet maksimalisht që ta rritë numrin e votave për këtë parti në zgjedhjet lokale. "Rezultatet e zgjedhjeve më 6 tetor janë shembulli më i dukshëm i nevojës për ndryshimin në tërë Kosovën. Dua të them se kemi pësuar ulje të votave për sa i përket KDTP-së dhe nuk jam kënaqur me rezultatet e zgjedhjeve. Por besoj se do t'i analizojmë mirë rezultatet e zgjedhjeve dhe do të mundohemi të rrisim këtë në zgjedhjet lokale", ka thënë Damka.

"Epoka e re": Cilat do të jenë prioritetet e Partisë Demokratike Turke të Kosovës?

Damka: Së pari nëpërmjet kësaj interviste dua t'i falënderoj edhe

QKMF-së në Malishevë i jepet donacion një autoambulancë

MALISHEVË, 14 NËNTOR (ER) - Qendres së Mjekësisë Familjare në Malishevë (QKMF) edhe zyrtarisht i është dorëzuar një autoambulancë, e cila është donacion gjerman. Kjo autoambulancë është sjellë në Malishevë nga përfaqësuesi i fondacionit, humanisti Rudolf Broer, ndërsa vetura dhe çelësat i janë dorëzuar kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj, e ky i fundit veturën dhe çelësat ia ka dorëzuar QKMF-së në Malishevë. "Malisheva ju ka shumë borxh dhe nuk do t'ju harroj asnjëherë. Ju jeni një humanist i madh dhe Komuna e Malishevës gjithmonë do t'ju kujtoj të tillë. Ne ju jemi mirënjohës për të gjitha që keni bërë për komunën tonë", ka thënë Begaj me rastin e pranimit të donacionit.

Humanisti Rudolf Broer dhe fondacioni të cilin e drejton "Luftbrücke" disa herë e kanë ndihmuar Komunën e Malishevës me donacione të tilla, siç është një kombibus për shërbimin e dializës për personat në nevojë, pastaj karroca për personat me nevoja të veçanta dhe shumë donacione të tjera. Kjo autoambulancë i është dhuruar Komunës së Malishevës me rastin e shënimit të 30-vjetorit të fondacionit "Luftbrücke", në një ceremoni zyrtare të organizuar në Gjermani.



Komuna e Prishtinës vazhdon investimet në infrastrukturën rrugore

PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se investimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zona rurale të Prishtinës janë duke vazhduar në mënyrë që të sigurohet qarkullim i lehtë për banorët e këtyre zonave. "Investimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zona rurale të Prishtinës vazhdojnë për të siguruar qarkullim të lehtë e të sigurt për banorët e këtyre zonave. Rruga që lidh fshatrat Busi e Marec ka marrë pamje tjetër pas përfundimit të punimeve dhe sinjalizimit. Edhe më e bukur duket në këto ditë vjeshtë!", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".



QKMF-së në Lipjan i shtohen edhe disa pajisje të reja

LIPJAN, 14 NËNTOR (ER)

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Lipjan kanë arritur pajisjet e reja dhe moderne si: ultrazë, defibrilatorë, numërues hematologjikë e sterilizatorë, karrige stomatologjike dhe EKG. Të gjitha këto pajisje janë investim i Drejtorisë së Shëndetësisë të Komunës së Lipjanit. Drejtoresha e Shëndetësisë në Lipjan, Vlora Limani-Hajnuni, ka thënë se këto janë pajisje të nevojshme dhe të domosdoshme që sigurojnë cilësi në shërbime shëndetësore për profesionistët mjekësorë dhe për pacientët.



Komuna e Klinës filloi shpërndarjen e serrave për fermerë

KLINË, 14 NËNTOR (ER) - Komuna e Klinës ka vazhduar programin për subvencione në bujqësi, duke shpërndarë 49 serra për fermerë përfitues. Për ta parë nga afër zbatimin e këtij projekti, drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Naser Morina, ka vizituar fshatrat Çabiq dhe Qupevë, ku ka parë montimin e serrave. Me këtë rast, drejtori Morina ka uruar përfituesit e këtij projekti dhe ka

theksuar se fokusi i qeverisjes komunale është që të rritet mbështetja e komunës ndaj fermerëve me qëllim që të krijohen mundësi më të mira dhe lehtësira financiare për bujqit. Morina ka thënë se këtë vit janë shpërndarë 49 serra, ndërsa në vitin tjetër synohet që numri i tyre të rritet dukshëm. Ndarja e serrave është bërë nëpërmjet thirrjes publike për aplikim nga ana e fermerëve.

IADK-ja përkrah shtatë fermerë të Drenasit me motokultivatorë


DRENAS, 14 NËNTOR (ER) - Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) në kuadër të projektit për bimë mjekësore dhe aromatike ka shpërndarë mekanizmin bujqësor për shtatë fermerë të Komunës së Drenasit të cilët kanë përfituar motokultivatorë të madhësive të ndryshme me frezë dhe kositëse. Këto pajisje do të ndikojnë në lehtësimin e punëve, efikasitetin dhe zgjerimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë mjekësore dhe aromatike.

IADK-ja, po ashtu, do të ofrojë këshilla praktike, trajnime dhe vizita të ndryshme me qëllim që përfituesit të kenë mundësi

pune dhe gjenerim të të ardhurave dhe zgjerim të veprimtarive të tyre në sektorin për bimë mjekësore aromatike. Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit: "Mbështetja e zinxhirit të vlerave të BMA përmes krijimit të punësimit dhe vazhimit të eksportit", përkrahur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, mandatuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë. Edhe Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Bujqësisë, këtë vit ka planifikuar të ndaj 100 motokultivatorë për fermerët e Komunës së Drenasit.



Regjisorja Arzana Kraja përcillet për në banesën e fundit



Regjisorja Arzana Kraja është varrosur të enjten në varrezat e Lagjes Arbëria në Prishtinë. Në ceremoninë e varimit të regjisores Kraja kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, artistë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë të shumë. Familja Kraja ka njoftuar se dyert e familjes do të jenë të hapura për ngushëllime në lagjen "Ulpiana D9", pranë klinikës "Fati im" në Prishtinë. Vdekja në moshë të re e Arzana Krajës ka tronditur të gjithë. Përfaqësues të institucioneve, liderë partiakë, ambasadorë të huaj e artistë kanë ngushëlluar familjen Kraja për ndarjen nga jeta të bijës së tyre

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Të enjten në varrezat e Lagjes Arbëria (ish-Dragodan) në Prishtinë i është dhënë lamtumira e fundit regjisores Arzana Kraja, vajzës së kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Mehmet Kraja, e cila ka ndërruar jetë të mërkurën në banesën e vet në Lagjen Kalabria. Në varrimin e regjisores Arzana Kraja kanë marrë pjesë qindra qytetarë, përfaqësues të institucioneve të vendit, të shoqërisë civile, përfaqësues të komunitetit artistik, miq dhe familjarë. Familjarët kanë njoftuar se dyert e familjes do të jenë të hapura për ngushëllime në lagjen "Ulpiana

D9", pranë klinikës "Fati im".

Ngushëllime familjes Kraja i ka shprehur presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, ministri në detyrë i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, deputeti LDK-së dhe ish-ministri i Financave, Avdullah Hoti, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), Qendra Kinematografike e Kosovës, përfaqësues të komunitetit artistik dhe përfaqësues të

shoqërisë civile si dhe dhjetëra figura të tjera publike.

Teatri Kombëtar i Kosovës, pas vdekjes së regjisores Arzana Kraja, i ka shprehur ngushëllime familjes Kraja dhe ka anuluar shfaqjet e parapara në këtë teatër.

Edhe Teatri i Gjilanit, për shkak të vdekjes së regjisores Arzana Kraja, ka anuluar shfaqjen "Im atë donte Adolfin" të autorit Mehmet Kraja që ka qenë e paraparë të shfaqjet të mërkurën.

Ndërkaq sot (e premte), me fillim nga ora 12:00, në Teatrin Kombëtar komuniteti artistik organizon takim përkujtimor për regjisorën Arzana Kraja.

Arzana Kraja ka dhënë kontribut në fushën e kinematografisë. Ajo njihet për filmin "Fusha e mëllenjave" që kishte hapur zyrtarisht

edicionin e 11-të të "PriFest". Filmi ishte prodhim i shtëpisë kinematografike Circle Production (Kosovë - Besnik Krapci) në bashkëpunim me Britaninë e Madhe dhe Action Production (Shqipëri - Gerta Qurku). Ky film është përkrahur nga Qendra Kinematografike e Kosovës dhe nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Shqipëri. Problemet e një të burgosuri politik shqiptar, i cili e ka vështirë të jetojë me të kaluarën, ishin shfaqur në filmin debutues të regjisores Arzana Kraja. "Fusha e mëllenjave" ishte pretendent për çmim edhe në ngjarjen prestigjioze të filmit "Berlinale".

Arzana Kraja ishte skenariste dhe regjisore edhe e filmit të metrazhit të shkurtër "Shkurta".



800 mijë euro pajisje të reja për sallat operative në QKUK dhe katër spitale

Prishtinë, 14 nëntor (ER) - Klinikat kirurgjike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe katër spitale të përgjithshme, i Gjakovës, i Pejës, i Mitrovicës dhe i Ferizajt janë pajisur me tavolina operative dhe me llamba operative.

Vlera e këtyre furnizimeve për salla operative është rreth 800

mijë euro, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dr. Basri Sejdiu, me këtë rast tha se furnizimi i sallave të operacionit në QKUK dhe spitale po bëhet me qëllim që të ofrohen kushte sa më të mira dhe sa më moderne për punë. Ai theksoi se ky furnizim

përfshinë tavolina dhe llamba operative për të gjitha sallat kirurgjike në QKUK dhe katër spitale të përgjithshme në kuadër të projektit për modernizim të sallave operative.

Drejtori Sejdiu njoftoi se kjo është mundësuar nga kursimi i buxhetit, ndërsa specifikimi teknik i pajisjeve është bërë nga ekspertë

të Bankës Botërore në Gjenevë. Vlera për QKUK për pajisje është 538 700 euro, përderisa për spitale 261 mijë euro.

Ky është vetëm një nga kontingjentet e furnizimeve me pajisje mjekësore të bërë këtë vit nga ShSKUK-ja, e cila po investon rreth 6 milionë euro për pajisje mjekësore.



Etika e shëndoshë sjell biznes të mirë



Sakip IMERI, drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti Kosovari i Konkurrencës

Ideja e këtij shkrimi është që të theksohet ana e drejtë e të bërit biznes, që në perspektivë afatgjatë është mundësi ideale për arritjen e synimeve personale të çdo personi që nis me bindjet e drejta për sukses. Në ditën ndërkombëtare të kontabilistëve, kontributi më i vlefshëm do të ishte rikujtimi i kodit të etikës së këtij profesioni. Sigurimi i konkurrencës së lirë në treg, duke i parandaluar marrëveshjet e fshehta, abuzimin me pozitën dominuese, përqendrimit, janë kërkesa ligjore të Autoritetit të Konkurrencës e që në vetvete përmbajnë misionin e ndërtuar mbi bazën e kodit të etikës së të bërit biznes.

Drejtesit e korporatave duhet ta kuptojnë se mënyra më e mirë për të arritur përfitime afatgjata është duke iu përmbajtur etikës së biznesit dhe duke përmbushur përgjegjësitë sociale të korporatës. Funksionimi i drejtë, pa ndikime dhe me pavarësi të plotë i parimeve etike të profesionit, janë kushtet bazë të funksionimit të biznesit të mirëfillt. Devijimi nga parimet etike të profesionit prish rregullin bazë të funksionimit normal të ekonomisë dhe shpie në mashtrime, pasojat e së cilës paraqiten në forma të ndryshme, varësisht nga shkalla e devijimit nga parimet bazë, synimi i mashtrimit dhe efikasiteti i organeve përgjegjëse për luftimin

e dukurisë së mashtrimeve. Nëse sillësh në mënyrë joetike për njëfarë periudhe mund të bësh shumë para, por këto veprime do të dëmtojnë fitimet e korporatës në periudhën afatgjatë dhe do të ndikojnë negativisht në fitimet e aksionarëve. Profesori amerikan McCabe, me pak fjalë, thotë: etika e shëndoshë sjell biznes të mirë. Roli dominant në luftimin e kësaj dukurie padyshim se është i profesionistëve të kontabilitetit dhe auditorëve. Sa janë të mbrojtur këto kategori nga ndikimet e ndryshme, joshjet, presioni i pronarëve të kapitalit ndaj drejtuesve të korporatave për rritjen e fitimeve dhe paraqitjes së "emrit të mirë" është e lidhur ngushtë me edukimin e mirë për rregullat e të bërit biznes të drejtë. Nder arsyet që drejtuesit e korporatave nuk zbatojnë etikë të shëndoshë, mund të shpjegohet me faktin se ata kurrë nuk kanë marrë mësim mbi këtë temë. Studimet tregojnë se kur studentët e shkollave të biznesit diplomohen, etika e tyre ka ndryshuar, ata janë shndërruar në individë më agresivë që nuk mendojnë për tjetër gjë përveç fitimeve.

Si definohet kodeksi dhe morali - etika?

Shprehja KODEKS prezanton një "përmbledhje të sistematizuar të dispozitave ligjore që e përbejnë sistemin e rrumbullakuar juridik" dhe "në kuptimin më të gjerë kodeksi është përmbledhje e parimeve ose te standardeve të sjelljes". Kodeksin e bën më të vlefshëm dhe më funksional edhe respektimi i parimeve të Moralit - Etikes.

Morali është sistem rregullash dhe normash të sjelljes. Ato janë të kufizuara në hapësirë dhe

kohë. Ajo që vlen në një kohë si kodeks moral nuk është e domosdoshme të vlej në një kohë tjetër. Ajo që konsiderohet e moralshme në një grup apo bashkësi shoqërore nuk është e domosdoshme që të jetë e moralshme në grupin tjetër. Normat morale nuk zbatohen me sistem dhune, ato pranohen vullnetarisht, çka i bënë ato autonome dhe efikase.

Ndërkaq e vërtetë është se morali është fenomen shoqëror dhe se nuk ka bashkësi njerëzore që nuk e njohin atë ose që nuk e praktikojnë një sistem të caktuar të normave morale. Normat e caktuara morale madje edhe tërësia morale po marrin kuptim universal, d.m.th. nuk kanë kufizime në hapësirë dhe kohë. Kështu normat morale nga kodeksi i Moisiut: "mos mbyt", "mos vjedhë", "duaje më të afërmin tënd" etj., ose normat morale të shpallura në Kuran dhe Hadithe që kanë të bëjnë me sjelljen e njeriut në bashkësi, janë norma me vlerë universale.

Sistemet e normave morale shumë shpesh janë kompatible me normat religjioze. Meqenëse normat morale, pranohen vullnetarisht nga anëtarët e bashkësisë, si një formë e sjelljes në bashkësi, mos respektimi i tyre nuk sjell reperkusione gjegjësisht detyrim së jashtmi. Mospërfillësi i normave morale përbuzet nga bashkësia, përjashtohet nga jeta shoqërore e grupit, kodeksin e të cilit e ka thyer. Dallimi i normave morale religjioze prej normave profesionale - juridike është se kundërvajtësi i normave juridike i bartë sanksionet të cilat i përshkruan organi profesional e shtetëror dhe e cila ka karakter detyrimi nga jashtë gjegjësisht ka karakter represiv.

Që normat e sjelljes të jenë të karakterit obligativ janë krijuar

kodekset për të gjitha profesionet që në parim kanë shumë ngjashmëri, me dallime në aktivitetet operative dhe fusha specifike të ushtrimit të profesionit.

Për t'i realizuar standardet profesionale të sjelljes etike, në profesionin e kontabilitetit është hartuar kodeksi për kontabilistët profesionist të cilët duhet t'i përmbushin këto katër kushte që njëkohësisht janë edhe qëllime të profesionit kontabël: 1. Informacione të vlefshme për të cilat ka nevojë e gjithë shoqëria, 2. Profesionalizëm, individët duhet qartazi të identifikohen të klientët si persona profesionist nga fusha e kontabilitetit, 3. Cilësia e shërbimeve, kërkohet që shërbimet profesionale të bëhen sipas standardeve më të larta profesionale, 4. Besueshmëria (siguria), përdoruesit e shërbimeve të kontabilistëve duhet të binden se kodeksi iu garanton ofrimin e shërbimeve të standardeve me të larta.

Që të jenë të plotësuar katër kushtet e mësipërme duhet të respektohen parimet kryesore të kontabilistëve profesionistë:

- Integriteti (ndershmëria). Kontabilisti profesionist duhet të jetë i sinqertë, i ndershëm kur i kryen shërbimet profesionale.
- Objektiviteti. Kontabilisti profesionist nuk lejohet të paragjykoj, të ketë konflikt interesash ose të influencohet nga të tjerët për të mënjeluar gjykimin profesional apo të biznesit.
- Zotësia profesionale dhe kujdesi i duhur. Kontabilisti profesionist ka detyrim të vazhdueshëm të zotëroj njohuri dhe aftësi profesionale në atë nivel, në të cilin garanton se klienti ose punëdhënësi i tij do të marrin shërbime profesionale kompetente, të cilat bazohen në zhvillimet aktuale të praktikës, të legjisllacionit dhe të teknikave përkatëse. Në kryerjen

e shërbimeve profesionale, një kontabilist profesionist duhet të veproj me kujdes dhe në pajtim me standardet profesionale e teknike.

- Besueshmëria (konfidencialiteti). Kontabilisti profesionist duhet ta respektoj parimin e besueshmërisë dhe të mos i përhap informacionet që i ka për klientin, përveç në ato raste kur me ligj është i detyruar t'i zbardhi botërisht.

- Sjellja profesionale. Kontabilisti profesionist duhet të ketë sjellje në përputhje me respektin që gëzon profesioni e jo të sillt në atë mënyrë që e diskrediton atë, dhe

- Standardet teknike. Kontabilisti profesionist duhet t'i ofrojë shërbimet në përputhje me standardet teknike dhe profesionale. Është e ditur se kontabilistët profesionist përballen me presione nga jashtë dhe brenda, nga më të ndryshmet, prandaj gjithmonë ekziston rreziku nga ndikimet e ndryshme në punën e tyre. Po ashtu gjatë zbatimit të standardeve, kontabilistët profesionist mund të përballen edhe me sjellje joetike, shpesh mund të gjenden në situata të konflikteve të interesave. Përballimi i tyre varet nga ndershmëria dhe njohuria e çështjes së konflikteve të interesit. Dallimet e mendimeve të kontabilistit profesionist dhe palës tjetër nuk janë vetëm çështje etike, por shumë më e thellë, andaj duhet hetuar të gjitha faktet dhe rrethanat.

Të gjitha situatat, që mund të krijohen gjatë punës së tyre, e që i vënë në dyshim parimet e profesionit të kontabilistit (kodeksin etik), duhet të shqyrtohen mundësitë e ndalimit të ndikimeve, e në rastet e rënda edhe të tërheqjes nga angazhimi. Profesori amerikan McCabe ka shumë të drejtë kur thotë: etika e shëndoshë sjell biznes të mirë.

Avancimi i sistemit të ndërmjetësimit, prioritet i sistemit të drejtësisë

PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER) - Është mbajtur tryeza me titull "Avancimi i sistemit të ndërmjetësimit në Kosovë", në të cilën kanë marrë pjesë kryeprokurorë dhe kryetarë të gjykatave të Kosovës. Kjo tryezë është mbështetur nga UNDP përmes projektit "Përfaqësimi i qasjes në drejtësi dhe i reformës së sundimit të ligjit në Kosovë" dhe financuar nga Ambasada e Norvegjisë në Kosovë.

Në këtë tryezë ka folur zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Arben Ismajli, i cili para pjesëmarrësve ka thënë se ndërmjetësimi si veprimtari jashtëgjyqësore është mundësi e



mirë për zvogëlimin e lëndëve nëpër prokurori dhe gjykata të Kosovës. Po ashtu, zëvendëskryesuesi Ismajli ka folur edhe për veprimet e marra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës lidhur me funksionalizimin sa më të mirë të ndërmjetësimit nëpër prokurori,

duke u fokusuar në punën që është bërë për hartimin e akteve nënligjore të hartuara nga KPK-ja, që rregullojnë fushën e ndërmjetësimit.

Ndërsa prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka folur për mundësitë

e mira që sjell ndërmjetësimi në sistemin e drejtësisë, por edhe për sfidat e implementimit të tij. Prokurori Kelmendi paraqiti të gjeturat lidhur me sfidat e implementimit të ndërmjetësimit në praktikë gjatë takimeve të mbajtura me administratorë dhe ref-

erentë të ndërmjetësimit të prokurorive dhe gjykatave.

Lidhur me punëtoritë dhe tryezat e organizuara për mbështetjen e implementimit të ndërmjetësimit foli menaxheri i projektit të UNDP-së, për fuqizimin e sundimit të ligjit, Ardian Latifaj.

Punëtorët e sektorit privat në javën tjetër protestojnë

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Udhëheqja e Sindikatës së Pavarur e Sektorit Privat të Kosovës, e kryesuar nga Jusuf Azemi, ka marrë vendim për fillimin e protestave dhe grevave për punëtorët e sektorit privat lidhur me rritjen e pagave, zbatimin e Ligjit të Punës si dhe marrëveshjes kolektive. Azemi në një konferencë për media ka deklaruar se ka ende punëtorë që paguhen nga 130 dhe 170 euro.

Azemi ka thënë se janë duke kërkuar kushte më të mira të punës. "Sot kemi ardhur të takohemi që të vendosim për fillimin e protestave apo fillimit të grevave, varësisht prej situatës që e kemi. Javën e ardhshme do të fillojmë me protesta, pavarësisht që kemi rritje solide nga disa kompani. Ne si sindikatë mendojmë që ditën e martë, të mërkurën dhe të enjten e javës së ardhshme, të jetë një protestë njëorëshe, eventualisht dyorëshe, pastaj të premtën të

ulemi dhe t'i shohim rezultatet që na takojnë me ligj, pozitive apo çfarëdo qoftë dhe pas javës tjetër të futemi në grevë", ka thënë Azemi. Ai ka theksuar se paga prej 250 eurosh ka "vdekur" dhe se punëtorët duhet të paguhen 300 euro. "Njoftojmë opinionin publik, se paga prej 250 eurosh ka vdekur. Tani e tutje të gjithë ata që dëshirojnë të marrin shërbime nga sektori privat duhet të paguajnë 350 euro në muaj", ka thënë Azemi. /A. MAVRAJ



'NewCo Ferronikeli' reagon rreth zhvillimeve të fundit në fabrikë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Menaxhmenti i Kompanisë "NewCo Ferronikeli Complex LLC", pas organizimit të grevës së punëtorëve që ka rezultuar me ndërprerjen e prodhimit, duke i shkaktuar humbje të madhe kompanisë, ka sqaruar për opinion gjendjen reale. "Duke e çmuar kontributin e punonjësve të vet, menaxhmenti në bashkëpunim me Sindikatën e Punëtorëve të 'NewCo Ferronikelit' ka marrë vendim që secili i punësuar të përfitojë nga skema e planifikuar e bonuseve. Sipas kësaj skeme, punëtorët çdo muaj, përveç pagës të cilën e marrin me rregull, do të përfitojnë edhe bonuse shtesë. Kjo do të varet nga performanca e secilit punëtor dhe realizimi i planit të përcaktuar mujor. Ne si menaxhment jemi të bindur se kjo do të ndikojë në përmirësimin e performancës së punëtorëve dhe ngritjen e produktivitetit", është thënë në komunikatën e "NewCo Ferronikelit", duke u shtuar se për kompaninë punonjësit janë aset i çmuar, ndaj në vazhdimësi është punuar për përmirësimin e kushteve të tyre. "Punonjësve të 'NewCo Ferronikelit' iu ofrohen kushte të punës me standarde të larta ndërkombëtare duke filluar nga pajisjet për mbrojtje në punë, ushqimi cilësor në punë, transporti, përkujdesja mjekësore,



lavandëria për larjen e rrobave të punës, pagesa e orëve shtesë, pushimi me pagesë si dhe respektimi i të gjitha normave sipas ligjit të punës të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye duam të theksojmë se kërkesa e vetme e punëtorëve ka qenë rritja e pagës prej 100 eurosh për punonjës dhe asnjë arsye tjetër", thuhet në komunikatë.

Sipas kësaj komunikate, vlen të theksohet se paga mesatare e punonjësve të "NewCo Ferronikelit"-t është 550 euro, ndërsa paga më e ulët është 400

euro. "Fatmirësisht, pas takimeve të zhvilluara me Sindikatën e Punëtorëve të 'NewCo Ferronikelit' dhe duke ua sqaruar situatën, punëtorët janë rikthyer në vendet e tyre të punës dhe prodhimi është duke vazhduar sipas planit. 'Menaxhmenti i NewCo Ferronikelit' ka përpiluar dhe do të vazhdojë të përcjellë propozime për rritjen e pagës në formatin e lejimit të rimëkëmbjes së kompanisë, pa cenuar performancën operationale dhe financiare, njëkohësisht do t'i vazhdojmë investimet në të mirë

të punëtorëve dhe fabrikës", thuhet në komunikatën e "NewCo Ferronikelit". Në këtë komunikatë theksohet se Grupi Balfin e ka marrë në posedim kompaninë "NewCo Ferronikeli" rreth një vit më parë. "Vendimi i parë i menaxhmentit të ri ishte që pa asnjë lloj obligimi ligjor t'ua paguante punonjësve të gjitha pagat e prapambetura dhe të papaguara, të cilat nuk i kishin marrë për disa muaj. Grupi Balfin ka injektuar miliona euro në investime për ta rifilluar punën e furrës dhe po planifikohen

miliona euro të tjera për investime kapitale. Më konkretisht, vetëm në vitin 2020 'NewCo Ferronikeli' ka të planifikuar që të investojë mbi 20 milionë në teknologji, në rritjen e efikasitetit, në përmirësimin e kushteve të prodhimit dhe të punës në fabrikë si dhe për hapjen e vendeve të reja të punës. Menaxhmenti i 'NewCo Ferronikelit' dhe Grupi Balfin po punojnë në strategji afatgjatë për zhvillimin e 'NewCo Ferronikelit'-t, duke e bërë atë konkurrent me fabrikat e tjera në botë", theksohet në këtë komunikatë.

BQK-ja: Opinioni publik të mos bie pre e informacioneve për shitblerjen e bankës TEB

PRISHTINË, 14 NËNTOR (ER) - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) përmes një reagimi ka bërë me dije se opinioni të mos bie pre e informacioneve të publikuara në rrjetet sociale në lidhje me shitblerjen bankës "TEB sh. a." nga biznesmenët rusë. "Në BQK nuk ka pasur asnjëherë kërkesë për ndërrim të pronësisë së kapitalit aksionar të kësaj banke, e cila që nga fillimi është nën pronësi të 'BNP Paribas

Fortis Yatç?mlar Holding A.?' dhe 'Çolakoglu Group Joint Venture'. Banka 'TEB', së bashku me bankat e tjera që janë të licencuara, kanë luajtur dhe po luajnë rol shumë të rëndësishëm për krijimin e një sistemi financiar të sigurt dhe të shëndoshë, i cili ka kontribuar në rritjen ekonomike të vendit dhe nxitjen e investimeve të jashtme, veçanërisht në sektorin financiar", thuhet në reagimin e BQK-së.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës siguron të gjithë qytetarët se i gjithë sektori financiar është i sigurt dhe nuk ka vend për shqetësim. "BQK-ja si mbikëqyrës i sistemit financiar do të vazhdojë të punojë në mbajtjen e një sistemi financiar të sigurt dhe të shëndoshë dhe do ta përmirësojë vazhdimisht mjedisin ekonomik në të cilin industria financiare operon", theksohet më tutje në këtë reagim.



GJEOPOLITIKË: BALLKANI PERËNDIMOR PAS REFUZIMIT NGA BE-ja

• Zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor duket gjithnjë e më i vështirë. Refuzimi i BE-së për ta filluar procesin e anëtarësimit për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë do të ndikojë në stabilitetin në rajon. Qasja e re e presidentit francez Emmanuel Macron për Ballkanin Perëndimor ka bërë që BE-ja të tërhiqet në nga integrimi në një partneritet strategjik, që tani po konsiderohet si një alternativë për anëtarësimin e plotë. Vendet e Ballkanit, të zhgënjyer nga ky përfundim, mund të rrëshqasin në iliberalizëm jodemokratik



Prof. Dr. Blerim REKA

Më 18 tetor Këshilli i BE-së shtyu fillimin e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut për herë të tretë. Zyrtarisht, tri shtete anëtare, Franca, Danimarka dhe Holanda, ishin kundër bisedimeve. Por, vendimtar ishte vendimi i presidentit francez Emmanuel Macron, i cili kërkoi një "metodologji të re" të zgjerimit, sipas së cilës, anëtarësimi i plotë i vendeve të Ballkanit Perëndimor mund të zëvendësohet me marrëveshje të tjera joanëtarësuese. Një raund i ri i zgjerimit pas një pauze 15-vjeçare duket gjithnjë e më pak i mundshëm. Me sa duket, anëtarësimi do të zëvendësohet me "partneritete të veçanta" ose, ndoshta, me Politikën Evropiane të Fqinjësisë, megjithëse kjo ka më pak të ngjarë.

Qasja kufizuese e BE-së drejt zgjerimit do të shkaktojë zhvillime të paparashikueshme gjeopolitike dhe të brendshme në Ballkanin Perëndimor. Lënia e pranimit në pritje, do të thotë një vakum strategjik në rajon, duke i lejuar zbarkimin në rajon të aktorëve joeuroatlantikë. Duke mos shpresuar të bëhen pjesë e një Evrope të bashkuar, vendet e Ballkanit mund të kthehen në bashkim brenda

kufijve kombëtarë. Nëse projekti panevropian dështon në rajon, atëherë Kosova mund të kërkojë të bashkohet me Shqipërinë, ose Serbia mund të përpiqet ta integrojë entitetin boshnjak të Republika Srpska.

Në tetor presidenti serb Aleksandar Vuçiq dhe presidenti i Republika Serpska, Milorad Dodik, u takuan me kryeministrin rus, Dmitry Medvedev, në Beograd dhe diskutuan për anëtarësimin në Bashkimin Euroazian. Serbia nënshkroi traktatin e pranimit më 25 tetor 2019. Presidenti Vuçiq u takua, gjithashtu, me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe kryeministrin shqiptar Edi Rama, në Novi Sad dhe më vonë edhe në Ohër, për ta promovuar idenë e tij për një "minishengen ballkanik", si një përpjekje për ta zëvendësuar integrimin në BE me integrimin rajonal. Presidenti Vuçiq prezantoi projektin duke thënë: "Ne duhet të kujdesemi për veten tonë dhe duhet të mendojmë për lidhje rajonale pas refuzimit të BE-së". Kosova dhe Mali i Zi e hodhën poshtë propozimin, duke e konsideruar atë një zëvendësim të rrezikshëm për anëtarësimin e rajonit në BE.

Sipas një studimi të fundit, në Maqedoninë e Veriut 8.5 për qind e qytetarëve të saj e perceptojnë Serbinë si aleatin më të ngushtë të vendit, krahasuar me 7.7 për qind për Turqinë dhe vetëm 4.7 për qind për BE-në. Një qeveri e përkohshme do të jetë në detyrë deri në zgjedhjet e parakohshme më 12 prill 2020. Vendi është i gatshëm t'i bashkohet NATO-s, ku në fund të tetorit 2019, 86 për qind e

anëtarëve të NATO-s kishin ratifikuar protokollin e pranimit.

Fundi i zgjerimit?

Sipas të gjitha gjasave, përgjigja e tretë negative e Brukselit për Tiranën dhe Shkupin jo vetëm se do ta shkaktojë zhgënjimin e madh me BE-në, por mund të ndikojë në qeveritë, duke çuar në zgjedhje të parakohshme dhe konfigurime politike të paparashikueshme.

Në Maqedoninë e Veriut zgjedhjet e parakohshme janë caktuar për 12 prill të vitit të ardhshëm. Opozita në Shqipëri kohët e fundit ka kërkuar zgjedhje të parakohshme dhe dorëheqjen e kryeministrit Rama. Kjo e fundit ka hedhur poshtë kërkesat, por situata mund të eskalojë me shpejtësi.

A do të shtyjë ky zhgënjim popullor ndaj BE-së në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut drejt narracioneve më nacionaliste dhe qeverive të reja anti-BE?

Kjo nuk ka gjasë, duke marrë parasysh që të dy vendet kanë përsëritur përkushtimin e tyre për në BE. Në Maqedoninë e Veriut presidenti Stevo Pendarovski dhe të gjitha partitë politike riafirmuan orientimin strategjik të vendit drejt BE-së dhe NATO-s, menjëherë pas njoftimit të Brukselit. Kryeministri shqiptar Rama, po ashtu, deklaroi gatishmërinë e tij për të qëndruar në rrugën drejt integritimit në BE.

Por ky refuzim i tretë nga Këshilli i BE-së, megjithatë i dërgoi mesazh rajonit se anëtarësimi i tyre në BE është i pasigurt. Rasti i Turqisë në relacion me BE tregon se kjo mund ta shtyjë rajonin drejt Rosisë. Ashtu si Kroacia, Turqia filloi negociatat e pranimit në tetor 2005, por që nga atëherë nuk është arritur përparim dhe vendi tani është në një partneritet strategjik me Rosisë.

BE-ja bëri llogari të gabuar kur dështoi për të shpallur një datë për fillimin e negociatave të pranimit (e që është vetëm fillimi i një procesi të gjatë), por qeveritë e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut janë, gjithashtu, përgjegjëse për këtë rezultat negativ. Sundimi i ligjit mbetet një parakusht kryesor për pranimitin në BE. KE-ja kishte tetë kërkesa për Shqipërinë dhe katër për Maqedoninë e Veriut në këtë fushë. Të dy qeveritë e nënvlerësuan rëndësinë e këtyre kritereve, veçanërisht në

një kohë kur sundimi i ligjit po bëhet një çështje thelbësore jo vetëm në nivelin e BE-së, por edhe për vendet anëtare të BE-së.

Për më tepër, strategjia e re franceze për Ballkanin Perëndimor - që mbështetet në doktrinën e presidentit Macron për integrim më të thellë, jo më të gjerë - me siguri do të jetë që ta shtyjë zgjerimin në mënyrë të konsiderueshme. "Metodologjia e re" e propozuar do të çojë në një proces të ngadaltë, më kufizues dhe të kthyeshëm të negociatave anëtarësuese. Kjo, gjithashtu, mund të çojë në "pranimin e përkohshëm", që do të thotë një formë e revokueshme e integritimit.

Me gjasë nuk do të ketë zgjerim para se të zhvillohet një reformë institucionale brenda BE-së. Modeli i ri i marrëdhënieve të BE-së me Ballkanin Perëndimor, i cili nuk do ta garantojë anëtarësimin e plotë në BE, nuk përjashtohet. Përveç këtij orientimi strategjik, procedurat dhe instrumentet e zgjerimit do të rishikohen gjithashtu. Do të prezantohet edhe revokimi, i cili do t'i lejojë KE-së të tërhiqet gjatë procesit të pranimit nëse e vlerëson të nevojshme. E gjithë kjo do të zgjasë në mënyrë të konsiderueshme rrugën për anëtarësim. Prandaj, është joreale të pritët që një shtet i Ballkanit Perëndimor të hyjë në BE para vitit 2040.

Qasja e presidentit Macron ndaj Ballkanit Perëndimor nënkupton një qëndrim shumë më të ashpër ndaj procesit të zgjerimit të BE-së në rajon, duke kërkuar reforma të thella në sundimin e ligjit. Komisioni Evropian ndoqi hapat e Francës duke publikuar, në korrik 2019 "Blueprint Action for Rule of Law". Bazuar në këtë dokument të ri të KE-së, sundimi i ligjit do të jetë prioritet kryesor i Këshillit Evropian. Do të krijohet një cikël rishikimi për t'i monitoruar vendet anëtare dhe një mekanizëm për ta zbatuar sundimin e ligjit në nivel të BE-së, atëherë "kur mekanizmat kombëtarë do të ngecin", ai do të vendoset. Nëse krijohet një mekanizëm më i rreptë monitorimi për anëtarët e tanishëm të BE-së, çfarë duhet të presim për shtetet kandidate? Ka të ngjarë që BE-ja, ashtu si Franca, të marrë një qasje shumë më të rreptë drejt zgjerimit të BE-së, me theks shtesë në shtetin juridik.

Degolizmi i ri

Implikimi i këtyre dy dokumenteve u bë i qartë më 18 tetor, kur Këshilli Evropian nuk njoftoi një datë për fillimin e negociatave të pranimit. Në vend të kësaj, Këshilli deklaroi se do ta rivlerësonte çështjen në mbledhjen e KE-së në maj 2020 në Zagreb, megjithëse Italia po përpiqet ta përfshijë atë në agjendën e takimit të 19 nëntorit të Këshillit për Çështje të Përgjithshme.

Liderët kryesorë të BE-së (Donald Tusk, Jean-Claude Juncker, Johannes Hahn, Federica Mogherini) ishin zhgënjyer nga dështimi i KE-së për të shpallur një datë dhe Parlamenti Evropian ripërsëriti kërkesën për negociatat anëtarësuese. Në Bullgarinë fqinje, një protestë kundër refuzimit të KE-së u organizua para Ambasadës Franceze në Sofje, me protestuesit që akuzuan BE-në, se "përsëri e la rajonin në periferi të historisë". Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë shprehur zhgënjimin e tyre me vendimin e Këshillit Evropian, kurse Ministria e Punëve të Jashtme e Rosisë pyeti: nëse ShBA-ja ndan kufirin me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut? Kjo korrespondencë e pazakontë diplomatike midis Uashingtonit dhe Moskës tregon edhe një herë se Ballkani mbetet një vend strategjik në Evropë.

Në vitin 2020, pasi Mbretëria e Bashkuar të largohet nga BE-ja dhe kancelarja gjermane Angela Merkel të tërhiqet, Macroni do të mbetet si udhëheqësi mbizotërues në Evropë. Ai mund të miratojë një qëndrim të ngjashëm me atë të presidentit Charles de Gaulle pas Luftës së Dytë Botërore: Franca lart, Gjermania poshtë dhe Britania e Madhe jashtë.

Ky vizion mund të krijojë ndarje të thella në të gjithë kontinentin, duke përplasur Evropën e vjetër me Evropën e re, veriu me jugun, qendrën me periferinë. Nëse Ballkani Perëndimor mbetet jashtë BE-së, vendet e tij mund ta "importojnë" modelin qeverisës të kryeministrit hungarez Orban të demokracisë iliberale dhe ngadalë t'iu kthehen sistemeve parademokratike.

Skenarët

Skenari më i mundshëm nga një këndvështrim gjeopolitik është që refuzimi i Këshillit të BE-së

do ta prekë gjithë rajonin, jo vetëm Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Mund të ketë dëme anësore, por humbja kryesore do të jetë uniteti evropian. Siç përmendi Komisarë Evropian për Fqinjësinë Evropiane dhe Zgjerimin, Johannes Hahn, vendimi rrezikon "destabilizimin e Ballkanit Perëndimor". Por tani, si do t'i bindë Brukseli gjashtë vendet e rajonit që prisnin me dekada para deryve të tij që përpjekjet e tyre për t'u anëtarësuar? Si do t'i bindë BE-ja Kosovën dhe Serbinë që t'i normalizojnë marrëdhëniet e tyre bilaterale nëse Brukseli refuzon ta shpërblejë marrëveshjen Maqedoni-Greqi për emrin?

Vendet e Ballkanit Perëndimor aktualisht gjenden në një situatë të ngjashme me Evropën Qendrore dhe Lindore në vitet 1990 - duke u përballur me një të ardhme të pasigurt, duke pritur të shohin nëse do të bëhen anëtarë të Unionit një ditë. T'i humbësh shpresat duke zëvendësuar anëtarësimin me një partneritet strategjik të modeluar në politikën e fqinjësisë evropiane do të ishte një gabim strategjik.

Ndikimi në rajon ka të ngjarë të jetë edhe më i keq. Vendet kandidatë nuk do të jenë të gatshme të presin për "metodologjinë e re" të paralizuar të anëtarësimit, duke ndjerë se mungesa e planifikimit strategjik mund t'i linte ato të qëndrojnë para derës së BE-së edhe për njëzet vjet të tjera. Pasiguria ka vazhduar për një kohë të gjatë, veçanërisht tani kur rajoni përballlet me migrime kaq akute demografike. Planifikimi i paqartë evropian do t'ua hapë derën kërcënimeve të sigurtisë. Paratë kineze dhe armët ruse do të ofrojnë një alternativë për rajonin.

Për kohëzgjatje, më 24 tetor, një tren mbërriti në Beograd nga Kina, duke përruruar një hekurudhë të re për bartjen e mallrave midis dy vendeve. Në të njëjtën ditë, sistemet raketore S-400 ruse mbërritën në Serbi. Një ditë më vonë kryeministrja serbe Ana Brnabić nënshkroi traktatin e pranimit të Bashkimit Euro-Aziatik, duke iu bashkuar projektit të Moskës për integrim rajonal. Pas 20 vjet pritjesh të pafrytshme dhe asnjë qartësi përpara, BE-ja rrezikon ta lë rajonin larg Evropës dhe drejt integritetit rajonal me Lindjen. Vendet e Ballkanit janë shumë të vogla për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe kanë nevojë për aleanca ndërkombëtare. Të braktisura nga BE-ja, vetëm anëtarësimi i tyre në NATO do të parandalojë që historia të përsëritet.

(Botuar në Geopolitical Intelligence Services. Përktheu nga anglishtja në shqipe dhe përshtati: Arsim R. Osmani)

Strategjitë dhe qasjet teknike për përforcimin e bashkëpunimit në mes të parlamenteve dhe institucioneve supreme të auditimit

PODGORICË, 14 NËNTOR (ER) - Përfaqësues nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës morën pjesë në punëtorinë rajonale me temë "Strategjitë dhe qasjet teknike për përforcimin e bashkëpunimit në mes të Parlamenteve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA)" të mbajtur në Podgoricë nga 12 deri më 14 nëntor.

Punëtorinë u organizua nga Parlamenti i Malit të Zi dhe Banka Botërore si dhe është mbështetur nga Fondi i Forcimit të Mjedisit të Përgjegjshmërisë dhe Mirëbesimit (FFMPM), i themeluar nga sekretariati shtetëror zviceran për çështje ekonomike dhe Komisioni Evropian. Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin deputetë nga parlamentet dhe përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo punëtori ishte aktiviteti përcjellës nga punëtorinë e mbajtur në muajin maj në Tiranë, me temë "Fuqizimi i marrëdhënieve të Parlamentit dhe Institucioneve Supreme të Auditimit për të përmirësuar performancën e auditimit të jashtëm në Shtetet e Ballkanit Perëndimor".

Pjesëmarrësit e kanë njoftuar njëri-tjetrin lidhur me përparimin në zbatimin e planeve të veprimit për të cilat janë pajtuar në punëtorinë e mbajtur në Tiranë. Përmes diskutimeve pjesëmarrësit shkëmbyen edhe përvojat e vendeve të tyre lidhur me rolin e parlamentit dhe komisioneve respektive për mbikëqyrjen e financave publike, çështjen e shqyrtimit të raporteve të auditimit si dhe mënyrat e bashkëpunimit për krijimin e një marrëdhënie më efektive.

Tema të tjera të diskutimit dhe



shkëmbimit të përvojave në kuadër të punëtorisë lidhen me memorandumimin e bashkëpunimit në mes të Parlamentit dhe ISA-ve, kuptimi i raportit të auditimit, përdorimi i raportit të auditimit për ta shqyrtuar performancën e

qeverisë dhe subjekteve të audituara, monitorimi i rekomandimeve etj. Në këtë punëtori nga Zyra Kombëtare e Auditimit morën pjesë ndihmësauditoret dhe përgjithshëm Naser Arllati,

drejtori i përgjithshëm Imri Semtishti, udhëheqësja e Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim, Saranda Husaj-Baraliu dhe auditorekëshilltare për Kuvend, Violeta Smajlaj. Ndërsa në emër të Kuvendit të Kosovës mori pjesë stafi mbështetës i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Po ashtu, pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në kuadër të kësaj punëtorie, pjesëmarrësit vizituan edhe Parlamentin e Malit të Zi, ku u mirëpritën nga kryetari Ivan Brajoviq, i cili i ka njoftuar lidhur me punën e parlamentit dhe komisioneve parlamentare. Po ashtu, pjesëmarrësit kanë vizituar edhe Institucionin Supreme të Auditimit të Malit të Zi ku janë pritur në një takim të veçantë nga presidenti i këtij institucioni, Milan Daboviq.

Auditori i Përgjithshëm viziton Gjykatën Evropiane të Auditorëve

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, i shoqëruar nga zëvendësi i tij Ilir Salihu, kanë zhvilluar një vizitë zyrtare në Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA) në Luksemburg, ku janë takuar me kryetarin e ECA-së, Klaus Hainer Lehne. Sipas një njoftimi për media të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, në këtë takim biseda është fokusuar për vazhdimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në nivel profesional. Po ashtu, temë e bisedimeve

ishte edhe pjesëmarrja e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKAK) në programet dhe aktivitetet e institucioneve evropiane të auditimit. Auditori i Përgjithshëm, Osmani, ka uruar Lehne për emërimin e tij edhe për një mandat tjetër si president i ECA-së dhe e ka falënderuar atë për mbështetjen e vazhdueshme dhënë ZKAK-së, veçanërisht për ofrimin e mundësive për auditore e ZKAK-së që të marrin pjesë në programet e praktikës profesionale. Sipas këtij njoftimi, kjo paraqet një mundësi shumë

të mirë për auditorët e ZKAK-së që të njoftohen me praktikatat e mira evropiane për auditim dhe të mësojnë drejtpërdrejt nga ekspertët e ECA-së. Presidenti i Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Klaus Hainer Lehne, i ka vlerësuar të arriturat e ZKAK-së dhe ka rikonfirmuar mbështetjen e ECA-së për ZKAK-në si në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, po ashtu edhe në përfshirjen e ZKAK-së në programet e organizimit rajonale dhe evropiane të auditorëve.



Takimi Trump - Erdogan dhe transaksionet e Ankarasë me Moskën

Dy presidentët i përshkruan diskutimet në Shtëpinë e Bardhë si produktive dhe të sinqerta, mirëpo Trumpi tha se blerja nga Turqia e armatimeve të sofistikuara ruse, si sistemi S-400, krijon sfida serioze për ne dhe shpresojmë se do të arrijmë ta zgjidhim këtë situatë



WASHINGTON, 14 NËNTOR - Nuk ka shenja se bisedimet e së mërkurës mes udhëheqësve të ShBA-së dhe Turqisë sollën ndonjë përmirësim në marrëdhëniet e rënduara mes dy vendeve.

Dy presidentët, Donald Trump dhe Rexhep Tajip Erdogan, i përshkruan diskutimet në Shtëpinë e Bardhë si produktive dhe të sinqerta. "Blerja nga Turqia e armatimeve të sofistikuara ruse, si sistemi S-400, krijon sfida serioze për ne", tha presidenti Trump në një konferencë të përbashkët për shtyp me Erdoganin, ka njoftuar voa. "Shpresojmë se do të arrijmë ta zgjidhim këtë situatë", tha ai.

Blerja e sistemit rus S-400 për mbrojtje nga raketat shkel Ligjin CAATSA-Akti Ligjor për Kundërpërgjigje ndaj Rivalëve të Amerikës, që ndalon blerjen e sistemeve të rëndësishme ushtarake nga Rusia. Si rezultat, ShBA-ja e nxori aleaten e vet të NATO-s, Turqinë, nga programi i Avionëve Luftarakë F-35.

Duke folur për fërkimet që kanë lindur lidhur me sistemet S-400 dhe F-35, presidenti Erdogan tha "vetëm me dialog mund t'i kapërcejmë pengesat që hasim". Udhëheqësi turk sugjeroi blerjen e sistemit amerikan Patriot për mbrojtjen nga raketat, nëse ofrohet me çmim të pranueshëm. Zyrtarët e dy vendeve thonë se janë planifikuar diskutime të tjera të nivelit të lartë në përpjekje për të zgjidhur këtë çështje kritike.

Presidenti turk diskutoi kohët e fundit me udhëheqësin rus për blerjen e avionëve luftarakë rusë Su-57 dhe Su-35, nëse nuk arrin të blejë avionë amerikanë.

Një veprim i tillë do ta

kërcënonte anëtarësinë e Turqisë në NATO.

Presidenti Trump, në konferencën për shtyp të mërkurës, nuk foli për këtë problem, duke e lavdëruar Turqinë si një aleate shumë e vlefshme në NATO.

Në fillim të javës një grup dypartiak ligjvënësish i dërgoi presidentit një kërkesë me shkrim që ta anulonte takimin me presidentin turk si rezultat i veprimeve "shkatërrimtare" të Erdoganit në Siri dhe, gjithashtu, për blerjen e sistemit S-400 nga Turqia. "Nisur nga kjo situatë, besojmë se është e papërshtatshme që presidenti Erdogan ta vizitojë ShBA-në", thuhej në letrën e ligjvënësve.

Pak para mbërritjes së Erdoganit në Shtëpinë e Bardhë, udhëheqësi i shumicës demokrate në Dhomen e Përfaqësuesve, Steny Hoyer, e quajti "të turpshme" që presidenti Trump ta priste Erdoganin, duke e akuzuar udhëheqësin amerikan se "po mbyll një sy para veprimeve të udhëheqësve të huaj, të cilët kanë marrë në dorë autoritetet e zgjeruara dhe përpiqen të sundojnë si autokratë, duke minuar demokracinë në vendet e tyre dhe duke shfrytëzuar përçarjet dhe konfliktet etnike për ta rritur legjitimitetin e tyre". Komente të ngjashme bën Nancy Soderberg, ish-zëvendëskëshilltare për sigurinë kombëtare dhe konsulente në organizatën e paanshme, politika për Amerikën. "Ne duhet ta pezullojmë anëtarësinë e Turqisë në NATO si rezultat i spastrimit etnik dhe masakrave të tjera që ka bërë në Siri, duke detyruar mbi 180 mijë civilë të largohen nga banesat. Duhet të dënojmë, jo të festojmë, dikta-

torin Erdogan, i cili vë në shënjestër kundërshtarë politikë, pakica dhe organizata joqeveritare në vendin e tij", thotë Soderberg.

Analisti i politikës së jashtme, Dario Cristiani, studiues në Fondin Marshall në Shtetet e Bashkuara, gjithsesi mendon se "presidenti Trump veprroi si duhet që u takua me Erdoganin". Cristiani tha se me gjithë shtimin e tendencave nacionaliste e autoritare të udhëheqësit turk, "Turqia mbetet një aleate e rëndësishme e NATO-s dhe një vend me rëndësi kyçe për balancën gjeopolitike në një pjesë të rëndësishme të botës. Si rezultat, dialogu me Turqinë mbetet me rëndësi kritike, megjithëse duhet të vazhdojnë të kenë rëndësi edhe praktikatat turke kundër demokracisë dhe të drejtave të njeriut".

Pesë senatorë republikanë iu bashkuan presidentit për të pritë udhëheqësin turk të mërkurës në Shtëpinë e Bardhë. "Synimi i këtij takimi me miqtë

turq ishte një mësim mbi edukatën qytetare amerikane. Gjithsesi ky takim ne jep mundësi të jemi optimistë", tha Senatori Lindsey Graham në komentet për gazetarët.

Senatori Ted Cruz tha se përveç blerjes së sistemit rus S-400, ligjvënësit janë të shqetësuar edhe për trajtimin e kurdëve nga regjimi i Erdoganit. Qeveria turke i konsideron disa organizata dhe lëvizje kurde si terroriste.

Disa nga grupet paraushtarake kurde konsiderohen si aleatë nga Shtetet e Bashkuara në luftën kundër ISIS-it në Siri.

Në një intervistë me Shërbimin Kurd të "Zërit të Amerikës", Mustafa Bali, zëdhënësi i Forcave të Mbrojtjes Siriane, një grup kryengritës i udhëhequr nga kurdët, i bëri thirrje ShBA-së të mos sakrifikojë për interesat e saj ekonomike kurdët, të krishterët dhe grupe të tjera etnike e fetare në territorin sirian. "Presidenti Trump duhet t'i përbushë detyrimet morale dhe të mos lejojë spastrim etnik dhe inx-

hinierinë demografike që është praktikuar nga Erdoganin që kur forcat e tij u futën në Siri", tha Bali, duke akuzuar Turqinë se ka shkelur armëpushimin dhe ka zgjeruar territoret që kontrollon dhe që i ka etiketuar si "zona të sigurta".

Presidenti Erdogan, në një konferencë me gazetarë fajësoi terroristët kurdë se vazhdojnë të vrasin ushtarë e civilë turq. Ai tha se ia kishte kthyer prapa letrën që i kishte dërguar presidenti Trump, ku i thoshte të mos bënte "si i fortë" dhe të mos tregojë "budalla" duke filluar një ofensivë ushtarake në Siri.

Bisedimet mes presidentëve Trump dhe Erdogan u zhvilluan ndërkohë që ishin hapur seancat publike me dëshmi në kuadër të hetimeve që mund të çojnë në procesin për shkarkim të mundshëm të presidentit.

Në një konferencë me gazetarë, presidenti Trump tha: "Nuk kam parë asnjë minutë nga seancat", duke i cilësuar hetimet "një mashtrim që nuk duhet lejuar".

Disa të plagosur nga të shtënat në një shkollë në ShBA

WASHINGTON, 14 NËNTOR - Së paku gjashtë persona janë lënduar pasi një person i armatosur hapi zjarr në një shkollë të mesme në Kaliforni, njoftuan zyrtarët.

Incidenti ndodhi në Shkollën e Mesme Saugus në veri të Los Angeles, disa minuta para se të fillonte orari mësimor.

Policia e përshkroi të dyshuarin si një aziatik i veshur me roba të zeza, raporton BBC.

Autoritetet e mbyllën shkollën dhe institucionet tjera arsimore në afërsi.

Sipas faqes LA Times, i dyshuari është një 15-vjeçar.

Transmetimet e drejtpërdrejta

nga helikopteri treguan zyrtarët policorë në vendin e ngjarjes dhe të plagosurit duke u bartur përmes autoambulancave.

Policia iu bëri thirrje njerëzve që jetojnë në afërsi, të mbyllin dyert e shtëpive, derisa kërkimet për të gjetur të dyshuarin po vazhdojnë.



Eqrem Zenelaj boton librin e tij shkencor të njëmbëdhjetin me radhë

Prof. dr. Eqrem Zenelaj ditë më parë ka përruar librin e njëmbëdhjetë me radhë nga fusha shkencore. Libri i tij i fundit, i titulluar "Lufta e Trojës sipas diktit të Kretës dhe Darit të Frigjëve", është përruar në Sallën e Konferencave në "Grand Hotel", në praninë e dhjetëra personaliteteve. Profesor Zenelaj argumenton "lufta e Trojës ishte një luftë e fiseve të shumta popullore të së njëjtës origjinë në të dyja anët e brigjeve të Hellespontit dhe Egjeut dhe ishte një luftë rajonale e cila përfshiu tri kontinente: Evropën Juglindore, Afrikën veriore dhe Azinë e vogël dhe që kjo ka ndodhur prej vitit 1194-1184 para epokës së re".


Libri që ka dalë në dritë me titull "De Bello Trojano - Dictus Cretensis & Dares Phryges" është i një rëndësie të veçantë sepse deri më tash lufta e Trojës është kuptuar dhe shpjeguar vetëm sipas poemave të Homerit, "Iliadës" dhe "Odisesë" (pra në një kontekst mitologjik dhe

ky libër bazohet në dy shënime të rrëfimet me shkrim, pra në dy burime të tjera deri vonë të panjohura, ose pak të njohura, të dy autorëve të kohës që ishin vetë pjesëmarrës të luftës së Trojës, në të dyja anët kundërshtarë: Dikti i Kretës dhe Dari i Frigjëve. Autorët antik Trojën e vënë në

gërmimet arkeologjike të dr. Heinrich Schlimmann zbuluan edhe vendndodhjen e varrit të Akilit, Ajaksit, Helenit e të tjerëve, ku shkruhet se Aleksandri i Madh e kishte vizituar varrin e Akilit në Trojë (aty ku sot quhet Bunarbashqë). Gërmimet profesionale të ekipit të Heinrich Schlimmannit (me 80 veta në këtë ekip), zbuluan Trojën e vërtetë dhe aty gjetën tunele, mure, rrënoja, artefakte si dhe një pjesë të madhe të thesarit të Mbretit Priam.

Dikti i Kretës dhe Dari i Frigjëve, të dy ishin dëshmitarë dhe pjesëmarrës të luftës, të cilët kishin mbajtur shënime për ngjarjen dhe i kishin mbijetuar luftës. Dari i Frigjisë kishte qenë një njeri i ditur dhe njëherësh nëpunës apo shef i kabinetit të Hektorit, ndërsa Dikti i Kretës kishte qenë në anën e kundërt të trojanëve si shoqëruer i Agamemnonit. Ata të dy i mbijetuan luftës dhe ishin varrosur së bashku me dokumentet (shënime të tyre) të cilat ishin shkruar në Papirus egjiptian.

Ditari i Diktit të Kretës ishte përkthyer nga fenikishtja në koinën antike nga Eupraksi, ndërsa nga fenikishtja në latinishtje ishte përkthyer nga Lucius Septimos. Dikti ishte nga Kreta, nga qyteti Knosos dhe versioni i tij është më i gjerë se versioni i Homerit. Libri i Diktit të Kretës ka qenë në 9 vëllime në origjinal, ndërsa gjatë përkthimit është shkurtuar dhe njihen vetëm 6 vëllime. Ky libër i Diktit është tërësisht historik. Ngjarjet përshkruhen me besnikëri dhe saktësi, duke treguar edhe pamjet e heronjve



dhe fizikun e tyre, karakteret dhe zërin që kishin. Ky libër është zbuluar mes shek. IV-II. p. e. re. atje ku Dikti, pas Luftës së Trojës, kishte shkuar në vendin e tij në Kretë dhe kishte jetuar edhe një kohë, ndërsa po aty ishte varrosur së bashku me shënime të tij. Burim i dytë kryesor i këtij libri, sipas autorit, janë edhe shënime të Darit të Frigjëve. Dari i Frigjëve, po ashtu, ishte pjesëmarrës i luftës së Trojës dhe ishte nëpunës ose shef i kabinetit të heroit të Trojës, Hektorit. Sipas disa burimeve, bëhet me dije se Dari i Frigjëve si duket i takonte rrethit të grupit komplotist të Antenorit sepse ai i mbijetoi Luftës së Trojës duke lënë pas vetes këtë ditar në papirus egjiptian. Dari i Frigjëve ishte varrosur me shënime të tij në Trojë.

Nëse i krahasojmë shënime të Darit të Frigjëve dhe Diktit të Kretës për nga vëllimi, dallojnë pak mes tyre por, kryesisht, ngjarjet e luftës së Trojës janë të përshkruara përafërsisht njëjtë

me disa dallime të vogla. Edhe Homeri e përmend tek "Iliada" Darin e Frigjëve, të cilin e karakterizon si një njeri të ndërgjegjshëm, të pasur, të virtyshëm dhe si një prift i kohës. Zanafilla e luftës së tretë të Trojës dhe e hasmërisë mes këtyre dy palëve daton që nga koha e Mbretit të Trojës - Troit dhe Mbretit të Sipilusit Tantalit (i pari i Agamemnonit dhe Menelaut), ngjarje rreth 75-100 vjet, para Luftës së Trojës (1194-1184. p. e. re.). Lufta e Trojës (1194-1184. p. e. re.), të cilën ne e dimë deri më tash, ka qenë si vazhdim i dy luftërave të mëparshme e, në fakt, kjo e fundit ishte lufta e tretë dhe vendimtare e shkatërrimit të Trojës, sepse kjo ishte fundi dhe perëndimi i shtetit të Trojës. Autori Zenelaj në këtë libër ka shkruar duke u bazuar në dokumente të sakta dhe të pathëna deri më tani për luftën e parë të dytë dhe të tretë të Trojës, e ku lufta e tretë e tyre ka zgjatuar rrafsh 10 vjet, 8 muaj dhe 12 ditë.



hyjnor), pra këngë epike kushtuar luftës së Trojës (1194-1184. p. e. re.), të cilat këngë u kënduan brez pas brezi nga këngëtarë të ndryshëm, duke filluar nga Homerit (Melesigjeni).

Homeri ishte këngëtar i parë të cilit i faturohen këto dy poema (këngë) të cilat janë kënduar dhe përcjell brez pas brezi deri kur diktatori Pisistrati nga goja popullore i bënë këto këngë të shkruara në libër, aty në shek V. p. e. re. Duhet theksuar se në origjinal, "Iliada" dhe "Odiseja", vërtet flasin shqip, por grekët e rinj këto dy poema i falsifikuan dhe i ndryshuan, duke i zëvendësuar me emra të tyre por, fatmirësisht, aty-këtu kanë ngelur në shqip disa emra të heronjve, vendeve, zotave dhe personave të veçantë. Këtë studim dhe publikim, për luftën e Trojës, profesor Zenelaj e ka bazuar në një literaturë të gjerë si dhe në burime më të vjetra arkivore të autorëve të huaj. Sidomos

pjesën veriperëndimore të Azisë së Vogël, në afërsi të Dardaneleve, të cilat quhen sipas dardanëve. Straboni, gjeograf, topografinë e Trojës e vendos nga pozicioni i Malit Idha. Burimet historike dhe



E rrallë

I propozon të dashurës për martesë duke bërë sërif, unaza përfundon në oqean

Një burrë i ka propozuar të dashurës duke u ulur në gjunjë mbi tavolinën e sërfit. Lauren Oiye i tha "po" përpara se Chris Garth t'i binte unaza në oqean. Për fat të mirë ai kishte një unazë tjetër rezervë. Garth e dinte se diçka mund të shkonte keq, kështu që



unazën e vërtetë e la në breg të Queen's Beach në Waikiki, ku të dy u takuan vite më parë.

FOTO E DITES



Një grua shihet e mbështjellë duke u mbrojtur nga dëborat afër liqenit Michigan në Chicago. /AP/

E jashtëzakonshme

Lopët e hedhura në det nga Uragani Dorian gjenden gjallë

Tri lopë të hedhura në det nga Uragani Dorian janë gjetur gjallë pasi, siç duket, kanë notuar për disa milje. Lopët jetonin në ishullin Cedar, por u zhdukën në shtator pas uraganit të fuqishëm që përfshiu vendin. Mendoheshin se kafshët kishin ngordhur, por ato u gjetën në parkun Cape



Lookout National Seashore. Ndërkohë zyrtarët po përpiqen t'i kthejnë në shtëpi. Zyrtarët thanë se lopët mund të kenë notuar tetë kilometra.

BARSOLETA E DITËS



Burri i thotë gruas: Nëse s'do të kisha ty do të humbisja.
Gruaja: Kaq shumë më dashuron?
Burri: Jo, por nuk e di rrugën për në shtëpi.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
 Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
 Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
 Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Përgjatë gjithë ditës sot do të jeni në funksion të impenjimeve profesionale, ndërsa mbremja do t'ju gjejë në një ambient të ri.



DEMI

Çdo mjet ose kompromis do t'ia vlejë që ju ta fitoni lirinë e mendimeve. Nuk doni të jeni peng i klisheve të tjerëve dhe do të dini si të veproni.



BINJAKËT

Jeni zgjuar me ide mjaft të turbullta sot sa i përket një problemi të caktuar që duhet ta zgjidhni patjetër. Mund edhe ta devijoni gjatë pasdites.



GAFORRJA

Ngado që po dëgjoni plane për pushime juve po ju pëlqen kjo lloj ndjesie në ajër. Shumë shpejt do të niseni edhe ju në pushime.



LUANI

Keni mjaft probleme me punën ose biznesin tuaj dhe kjo nuk është periudha më e mirë për t'i zgjidhur.



VI RGJËR ESHA

Edhe pse mund të keni çaste që luhateni në idetë tuaja, në përgjithësi çdo gjë sot shkon shumë më mirë sesa që e mendonit.



PESHORJA

Planetët duket sikur luajnë me ju sot duke iu afruar ose duke iu larguar në çaste të caktuara objektivave tuaja parësore.



AKREPI

Po ëndërroni për detin sot sepse nga ritmet e ditës po e kuptoni që në krahasim me të tjerët, pushimet për ju janë ende larg.



SHIGJETARI

Sot dikush do t'ju kujtojë që jeta ka edhe detyrime dhe përgjegjësi që duhet të merrni mbi vetë. Deri më tani keni qenë të qetë nga kjo anë.



BRICJAPI

Ndiheni të ngarkuar emocionalisht këto kohë dhe doni patjetër të pushoni. Partneri nuk po ju ndihmon aspak për të kaluar këtë fazë tensioni.



UJORI


Nuk është se jeni në kohët tuaja më të mira dhe këto ditë do t'ju vërtetojnë që gjithçka po shkon keq. Mbase nga ngarkesat që keni në punë çdo gjë ju bën të nervozoheni.



PESHQIT

Më mirë se kaq nuk mund t'ju shkonte. Shijojini këto ditë sepse do t'ju vijnë të tjera me mjaft tension dhe debate.

Billie Eilish vjen me këngë të re



Këngëtarja e njohur Billie Eilish ka publikuar këngën më të re. Kënga quhet "Everything I wanted" dhe është

pëlqyer shumë nga adhuruesit e këngëtares. Në kanalin "Youtube" kjo këngë ka marrë pesë milionë klikime për pak orë.

'Lose you to love me' mori 138 milionë klikime në 'Youtube' brenda tri jave



Këngëtarja e njohur Selena Gomez ka publikuar para tri jave këngën "Lose you to love

you". Kjo këngë brenda kësaj kohe të publikimit ka marrë rreth 138 milionë klikime në kanalin "Youtube".



'People' shpall John Legend mashkullin më seksi të vitit

John Legend njihet si një ndër meshkujt e suksesshëm, por tani atij i është shtuar edhe një titull i rëndësishëm, pasi revista e njohur "People" e ka shpallur këngëtarin John Legend, mashkullin më seksi për vitin 2019. Siç bën me dije "People", këngëtari

i hitit "All of me" do ta mbajë tashmë titullin e dhënë vitin e kaluar për aktorin Idris Elba. Ky vendim i revistës së njohur e gëzoi veçanërisht bashkëshorten e tij modele, Chrissy Teigen, e cila ka publikuar foton e bashkëshortit dhe shkroi një dedikim.

A janë në lidhje të dashurisë Pete Davidson dhe Kaia Gerber?



Aktori i njohur Pete Davidson dhe modeluesja Kaia Gerber janë fotografuar nga paparacët teksa ecnin dhe mbanin duart e lidhura bashkë. Sipas "Page Six", ata u panë duke dalë nga një supermarket

në Hillsdale të Nju Jorkut. Davidson kishte të veshur një bluzë ngjyrë blu të errët, ndërsa modeluesja pati një palltë të materialit të lëkurës. Si duket aktori dhe modeluesja e njohur janë në lidhje të dashurisë.

Ky rrëfim duhet të lexohet nga të gjithë mësuesit

Një ditë, një i ri takon një të moshuar.

-Më mbani mend?

-Jo.

-Kam qenë nxënësi juaj.

- O gëzohem. Si je?

Me çfarë merresh tani?

-Jam bërë mësues.

-Gjykon se je i mirë në punën tënde?

-E vërteta është po. Ju më frymëzuat dhe doja t'ju ngjaja.



morët. Por vazhduat të kërkonit në xhepat e të gjithëve dhe kur mbaruat thatë: «Dhe tani mund të hapni sytë, Ora u gjend!» Nuk zutë emrin tim në gojë dhe as më tërhoqët vërejtje mënjane. Prisja

të më qortonit dhe të më bënit moral, por as këto nuk ndodhën. Atë ditë, ju shpetuat dinjitetin tim. Ajo ditë, ishte dita më e turpshme e jetës sime dhe më dhatë mënyrën tuaj një mësim të fortë. E

kujtuat tani rastin z. Profesor? -Po, duke të dëgjuar, i kujtova të gjitha. Por ka diçka që nuk më kujtohet, dhe ai je ti, sepse dhe unë i kisha sytë e mi mbyllur kur ju kontrolloja të gjithëve. /kultplus

Kurreshtar i moshuari, pyet të mësoj se çfarë i mbeti në mendje që e frymëzoi në këtë shkallë saqë donte ti ngjante. Dhe i riu i rrëfeu historinë e mëposhtme: -Një ditë një nxënës i klasës që ishte dhe shoku im, erdhi në klasë dhe më tregoi një orë të re shumë të bukur që mbante në xhep. Nuk ju përmbajtja tundimit dhe e vodha. Pas pak vuri re që i mungonte ora nga xhepi dhe menjëherë njoftoi profesorin që na jepte mësim atë moment në klasë, dhe ishit ju. Ju në vazhdim, iu drejtuat klasës dhe

thatë: - Ora e një nxënësi të kësaj klase u vodh në këtë orë mësimi. Kush e vodhi, ju lutem ta kthej menjëherë. - Kur mendova turpin e poshtërimit përpara gjithë shokëve të mi të klases, nuk guxova ta dorëzoja. Pastaj ju mbyllët derën, na thatë të qëndrojmë të gjithë në këmbë sepse do kontrollonit xhepat e gjithë nxënësve derisa ta gjenit. Por vendosët një kusht. Të gjithë duhet ti kemi sytë mbyllur të mos shikojmë fajtorin. Dhe kështu u bë. Kur arritët tek unë, e gjetët në xhepin tim dhe e

Gazetarja që mposhti 'botën e meshkujve', hyri në çmendinë dhe ndryshoi Amerikën



Sot, nuk ka statusin e një ylli, por Nellie Bly ka pasur një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin e shoqërisë.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, vetëm ideja që një grua mund të bëhej gazetarë, tingëlonte e cuditëshme. E megjithatë, Nellie ishte një reportere si askush tjetër në atë kohë.

Shkruante për fenomene sociale apo politike, e bënte anketime elektorale, edhe pse nuk kishte të drejtë vote.

Ishte e bukur dhe inteligjente, mund të bënte çdo gjë tjetër, por ajo kërkoi gazetarinë e kthyer në një "mollë të ndaluar" për gratë. Dhe ashtu bëri, duke fituar famë me disa reportazhe, dy nga të

cilat hynë në histori.

Me këmbënguljen e saj hyri në punë tek New York World, dhe i kërkoi redaktorit të bënte një udhëtim rreth botës tamam si ai që përshkruhet në librin e Zhyl Vernit, dhe e realizoi, e madje e mundi rekordin 80 ditor të personazhit me 8 ditë.

Çdo gjë u raportua më saktësinë

më të madhe. Aventura e dytë ishte ajo më e rëndësishmja në rrafshin gazetaresk: Nellie u hoq si e çmendur, dhe arriti të hynte në spitalin e parë të sëmundjeve mendore në Amerikë, ku flitej se pacientët trajtoheshin me brutalitetin maksimal.

Qëndroi 10 ditë brenda me të çmendurit, ku iu nënshtrua dhe

vetë trajtimit çnjerëzor, ku e lidhnin me zinxhirë, i bënin elektroshtok, e rrihnin dhe e zgjonin çdo mëngjes me një kovë ujë të ftohtë.

Paskësaj, kjo pioniere e gazetarisë investigative shkroi një reportazh që vuri në lëvizje sistemin e detyroi autoritetet të ndërhynin. /gazetashqip/

Gjashtë libra që Ismail Kadare rekomandon t'i lexoni

The Week publikoi listën e gjashtë librave që Kadare propozon për lexuesit e tij, libra të autorëve tjerë të cilët duket se shkrimtarit shqiptar i kanë lënë mbresë gjatë leximit.

“Ferri” – Dante Aligieri

Ky është libri i parë i Aligjerit në kuadër të Komedisë Hyjnore, pasuar nga Purgatori dhe Parajsja. “Ferri” merret me njo-hjen dhe refuzimin e mëkatit, në rrugën drejt Zotit.

“Don Kishoti” – Miguel de Cervantes Saavedra

Ky libër flet për aventurat e Don Kishotit. Historitë mbi kalorësit legjendarë vazhdonin të ishin ende shumë të lexuar në peri-udhën kur Servantesi shkroi Don Kishotin. Këto loj histor- ish e idealizonin kalorësin i cili vriste dragonj, monstra dhe

ushtri të pafundme armiqsh.

“Makbethi” – Shekspiri

Kadare është ngazëlyer nga Shekspiri dhe sidomos nga tragjedia e Makbethit. Makbethi është njëra ndër trag- jeditë e Shekspirit ku paraqitet lufta e përgjakshme për pushtet ne Skoci gjatë shekullit XI. Makbethi është një gjeneral në ushtrinë e mbretit dhe një ditë krejt papritur ai ndeshet me një magjistare. Magjistarja parashikon fatin e tij dhe i treg- on se një ditë ai do të bëhej mbret, por se nuk e dinte se ku.

“Frymë të vdekura” – Nikolai Gogoli

Libri është shkruar në vitin 1842, ndërsa nisi me një letër që Pushkini i dërgoi Gogolit ku i tha se duhej të shkruante një roman mbi Don Kishotin në

stilin rus. Mentaliteti, fajet, shfajësimet, morali rus është kryesori në këtë vepër.

“Nderi i humbur i Katerina Blum” – Heinrich Boll

Përralla e vitit 1974 mbi një vajzë të re dhe një gazetar që ia shkatërron jetën, është historia e fundit në këtë listë. Janë gjithsej dy filma të realizuar ndër vite mbi historinë e këtij tabloidi lajmesh dhe Katharinas.

“Procesi” – Franz Kafka

Kafka sjell te lexuesi një njeri që burgoset e persekutohet, por nuk dihet krimi i bërë nga ai. Vepra është shkruar midis 1914 e 1916. Libri është radhi- tur në dhjetë librat më të mirë gjermanë të botuar në shekullin 20-të. /Americaneye/



Protestuesit e MKRS-së triumfojnë, nuk vendoset presidenca në objektin e premtuar

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka njoftuar opinionin e gjerë me zhvillimet e fundit në lidhje me protestën që zyrtarët e Ministrisë kanë zhvilluar për 7 ditë pune me radhë, me qëllim kundërshtimin e zhvendosjes së kësaj Ministrie nga objekti ku ndodhet aktualisht, përkatësisht vendosjen e së njëjtës në objekt me qira.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), pas kërkesës zyrtare të parashtruar nga Këshilli Organizativ i Protestës për menaxhmentin e lartë të Ministrisë, ka mbështetur tërë- sisht kërkesën në këtë fazë dhe zyrtarisht i ka kërkuar Ministrisë së Administratës Publike (MAP), pezullimin e përkohshëm të zhvendosjes, kërkesë kjo që është pranuar nga MAP-i, e cila çështjen e kohës dhe mënyrën e zhvendosjes e ka lënë në përgjegjësi të menaxhmentit të MKRS-së.

Këshilli Protestues ka mirëpritur këtë marrëveshje të të dy min- istrive, e cila krijon kushte dhe hapësirë për të analizuar edhe njëherë arsyet dhe efektet e zhvendosjes, të cilat mundëso- jnë një vendimmarrje shumë më të qëndrueshme dhe më të drejtë për të gjitha palët.



Këshilli Protestues, për shkak të kësaj situatë, njofton pezullimin e përkohshëm të protestave të

përditshme dhe informon se do të vazhdojë të jetë funksional dhe i gatshëm për të kontribuar

në gjetjen e zgjidhjeve adekuate, të cilat nënkuptojnë rishqyr- timin e tërësishëm të planit për

vendosjen dhe akomodimin e MKRS-së dhe institucioneve të Republikës së Kosovës. /kultplus



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Kosova humbet nga Çekia, Evropianin e kërkon nga Liga e Kombeve

"Dardanët" humbën nga çekët të enjten në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Doosan Arena" në Plzen. Kjo humbje i ka lënë jashtë garës për kualifikim në Evropianin nëpërmjet kualifikuesëve, derisa një sukses të tillë u mbetet ta kërkojnë me anë të Ligës së Kombeve



humbjes, aventura e "dardanëve" ishte mjaft e suksesshme, derisa në ndeshjen ndaj Çekisë luajti pa tre lojtarë të formacionit bazë Vedat Muriqi, Arbër Zeneli dhe Hekuran Kryeziu. Kosova ndeshjen e fundit në këto kualifikime e zhvillon më 17 nëntor ndaj Anglisë në stadiumin "Fadil Vokrri", por kjo ndeshje do të jetë vetëm për prestigj.

Shqipëria befasohet nga Andorra

Kombëtarja e Shqipërisë e nënvlerësoi ndeshjen ndaj

Andorrës dhe barazoi me rezultat 2-2, në ndeshjen që u luajt në "Elbasan Arena", e vlefshme për eliminatorët e "Euro 2020". Shqipëria kaloi e para në avantazh në minutën e 6 të takimit me një goditje me kokë nga shkoderani Bekim Balaj. Ky avantazh zgjati vetëm për 11 minuta, pasi miqtë nga Andorra e barazuan rezultatit në të 17-n me Martinez. Pjesa e parë e ndeshjes mes Shqipërisë dhe Andorrës është mbyllur në barazim 1-1. Një mosmarrëveshje në mbrojtje ka bërë që ekipi i Andorrës të kalojë në avantazh përballë

Shqipërisë vetëm pak minuta pasi arbitri kishte nisur pjesën e dytë të ndeshjes. Është sërish Martinez. Shqipëria hidhet e gjitha në sulm pasi nuk mund ta pranojë një rezultat të tillë përballë Andorrës në fushën e saj. Ndërrimet e teknikut Reja shtuan forcat në sulm dhe në minutën e 56 të takimit vjen dhe goli i barazimit me Rey Manaj. Minutat e mbetura e gjejnë Kombëtaren Shqiptare në gjysmëfushën kundërshtare, por të pafuqishme për të finalizuar dhe në fund ndeshja përfundoi 2-2.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka lëshuar mundësinë që të arrijë në Kampionatin Evropian "Euro 2020" nëpërmjet kualifikimeve, pasi ka pësuar humbje në ndeshjen me të rëndësishme kundër Çekisë me rezultat 2-1. Nga Grupi A kualifikohen Anglia dhe Çekia. Ndeshja nisi më mirë për çekët të cilët dominuan në minutat e parë të ndeshjes, por portieri Aro Muriqi arriti fillimisht të bëjë një superpriftje në minutën e 7, kur gjuajtjen e Michael Krmencikit e devijoi mbi portë. Në minutën e 18 Vladimir Coufal rrezikoi edhe një herë portën e "dardanëve", por gjuajtja e tij përfundoi mbi portën e Muriqit. Më pas edhe Jakub Jankto (24') provoi nga gjuajtja e lirë, por sërish i pakapërcyeshëm ishte Aro Muriqi. Dominimi i

Çekisë vazhdoi edhe në minutat në vazhdim të pjesës së parë, kurse Kosova pati një gjysmë rasti në pjesën e parë që nuk e shfrytëzoi. Në fillim të pjesës së dytë "dardanët" ishin më të mirë dhe fillimisht portën e vendasve e rrezikoi kapiteni Amir Rrahmani, i cili gjuajti fuqishëm, por topi përfundoi afër portës. Në minutën e 51-të Hadergjonaj e shërbeu për mrekulli Atdhe Nuhiun që me kokë realizoi për 0-1. Krmencik dhe Jankto tatuan të barazojnë, por pa sukses. Mirëpo në minutën e 71-të Alex Kral e barazoi rezultatit me një gjuajtje të fuqishme jashtë zonës së rreptësisë. Pas këtij goli çekët e vazhduan kërkimin e golit të dytë, të cilin e arritën pas një rivënie nga këndi në minutën e 79, e autor i golit sërish ishte Alex Kral. Kosova nuk arriti të barazojë rezultatit në dhjetë minutat e fundit dhe ndeshja përfundoi 2-1. Pavarësisht

Bunjaki, këshilltar në Feronikel



PRISHTINË, 14 NËNTOR - Ish-selektori i Kosovës në futboll, Albert Bunjaki, është emëruar këshilltar i Klubit të Feronikelit nga Drenasi. Bunjaki, gjithashtu, ka marrë edhe postin e Instrukturit Teknik në UEFA, një pozitë e favorshme jo vetëm për të dhe klubin, por për gjithë futbollin e Kosovës. "Ai i besoi projektit të klubit, në krye me presidentin Naser Ramaj, me të cilin janë

akorduar për një bashkëpunim afatgjatë për riorganizimin e klubit. Kujtojmë se Bunjaki është një nga më meritoret që sot Kosova po luan një futboll mjaft cilësor. Albert Bunjaki pretendon në rritje të cilësisë së FC Feronikelit dhe shpreson në rritje të përgjithshme të Superligës së Kosovës, ku konkurrenca e lartë do ta bënte të domosdoshëm fuqizimin e të gjitha

klubeve pjesëmarrëse në Superligë", thuhet në njoftimin e Feronikelit. Bunjaku e ka vazhduar traditën familjare për të qenë pjesë e skuadrës së Feronikelit. Gjyshi i Albert Bunjakit ishte sponsori i parë i KF Feronikelit në atë kohë, gjithashtu edhe babai i tij ishte pjesë e Klubit nga Drenasi, kurse rrugën e tyre tash po e ndjek edhe Alberti.

Kombëtarja e Kosovës në turne të mirëseardhur në Turqi

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Përfaqësuesja A e Kosovës në hendboll (femrat) do të marrë pjesë në turneun ndërkombëtar që do të mbahet në Antalya të Turqisë prej 22 deri më 25 nëntor. Turneu për "dardanët" është i mirëseardhur, kurse e organizon Federata e Hendbollit të Turqisë. Në turne marrin pjesë

Turqia, Kosova, Italia, Maqedonia Veriore dhe Kombëtarja B e Turqisë. Më 22 nëntor Kosova është e lirë, ndërsa ndeshjen e parë e zhvillon më 23 nëntor kundër Italisë. Kjo ndeshje luhet nga ora 9:30. Të njëjtën ditë nga ora 19:00 vashat e Kosovës me ekipin B të Turqisë. Më 24 nëntor Kosova luan me

Turqinë A nga ora 19:00, kurse më 25 nëntor është ndeshja Maqedonia Veriore-Kosova, e cila fillon në ora 17:00. Kosova më 21 nëntor udhëton për në qytetin bregdetar turk. Turneu "2019 Antalya International Preparatory Tournament" do t'i shërbejë shumë selektorit Agron Shabani,

shtabit të tij, por edhe hendbolistëve. Shabani do ta ketë rastin që të provojë disa lojtare të reja që do ta rrisin konkurrencën në të ardhmen. Kosova është në mes të kampanjës kualifikuese për "Euro 2020". Është në grupin e tretë të fazës së dytë kualifikuese, kurse ndeshjet e ardhshme i zhvillon në fund të



marsit, kur e pret Bjellorusinë e më pas takohet me bjellorusët edhe në Minsk. Në grup janë edhe Gjermania dhe Sllovenia.

Rangersi mendon ta shesë ose ta huazojë Grezdën

GLASGOW, 14 NËNTOR - Futbollisti Eros Grezda vazhdon të jetë jashtë skuadrës së parë të skuadrës skoceze Rangers. Futbollisti shqiptar duket se nuk

është më në planet e trajnerit Stiven Gerrard dhe "Football Insider" raporton se klubi do t'i dëgjojë ofertat që do të vijnë në janar për të. Teksa dështuan që

të gjejnë një klub të ri në verë, ku në bisedime ishin edhe francezët e Dijonit apo Brestit, marrëveshja nuk u konkretizua. Grezda firmosi një kontratë

katërvjeçare kur u ble nga Rangersi për dy milionë paund prej Osijekut, por tashmë për të po mendohet formula e huazimit, ose edhe e shitjes.



Përballje interesante në Superligë

PRISHTIN, 14 NËNTOR - Xhiroja e 11-të e Superligës së Kosovës në basketboll do të zhvillohet sot (premtë) dhe nesër (e shtunë). Ndeshja e parë do të jetë ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Lipjanit. Ylli nga tetë ndeshje të zhvilluara deri më tani ka pesë fitore dhe tri humbje, kurse lipjanasit kanë nëntë humbje nga po aq ndeshje të zhvilluara. Sot, gjithashtu, ballafaqohen edhe rivalët e vjetër, Bashkimi dhe Trepça. Prizrenasit e kanë nisur mirë kampionatin, duke



shënuar shtatë fitore dhe dy humbje, kurse mitrovicasit kanë dy fitore dhe gjashtë humbje. Rahoveci të shtunën do të ndeshet me Feronikelin, skuadrën që ia ka shkaktuar humbjen e vetme në këtë edicion. Vreshtarët janë liderë me tetë fitore dhe një humbje, kurse skuadra nga Drenasi ka tri fitore

dhe gjashtë humbje. Xhiroja e 11-të përmyllet me sfidën shumë interesante në mes të Ponte Prizrenit dhe Sigal Prishtinës, që janë renditur në vendin e tretë, përkatësisht të katërt. Ponte Prizreni ka pesë fitore dhe katër humbje, kurse Prishtina ka pesë fitore dhe tri humbje.

SUPERLIGA - Java 11

Të premtën takohen:

17:00 Golden Eagle Ylli - Lipjani
19:00 Bashkimi - Trepça

Të shtunën takohen:

17:00 Rahoveci - Feronikeli
19:00 Ponte Prizreni - Sigal Prishtina

Hardeni leksion Clippersave, fitojnë edhe Lakersat dhe Toronto

HOUSTON, 14 NËNTOR - Skuadra e Houstonit arriti fitore me rezultat 102-93 ndaj Clippersave në takimin që vuri përballë njëra-tjetrës dy nga ekipet më të mira në NBA. Ekipi tekstan e meritoi fitoren pasi e udhëhoqi sfidën gjatë gjithë kohës, duke u shkëputur deri në 17 pikë. Megjithatë, në fund Clippersat hapën ndeshjen dhe tentuan të befasojnë por, pa sukses.

James Hardeni, me 47 pikë të realizuara, ishte shënuesi më i mirë për Houstonin, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e 12 reboundet e Leonardos për Clippersat. Me lehtësi arriti fitore edhe skuadra e Lakersave, që në fushën e saj mundi 120-94 Golden Staten, ndeshje e dominuar nga vendësit. Mungesa e titullarëve ndikoi te Warriors, ndërsa për Lakersat u dalluan LeBron Jamesi me 23 pikë e 12 asistime, mbështetur nga Davisi me 22 pikë. Fitore regjistroi edhe Minnesota, që mundi 129-114 San Antonion, duke korrur suksesin e tetë sezonal. Wiggins me



30 pikë e Townsi me 28 pikë bënë dallimin në parket për vendësit, ndërsa 27 pikët e DeRozan për Spursin mbetën për statistikë. Ndeshje spektakolare ajo e luajtur në Boston, ku vendësit fituan 140-133 ndaj Washingtonit. Gjithçka u vendos në pjesën e dytë për Celticsin, ku shtatë lojtarë realizuan mbi 10 pikë (Walker 25 pikë më i miri). Jashtë fushe triumfoi skuadra kampione e Torontos, që mundi 114-106 Portlandin (Siakam 36 pikë),

ndërsa Orlando triumfoi 112-97 ndaj Philadelphias (25 pikë e 12 rebounde për Vuqeviqin).

REZULTATET

Charlotte - Memphis	117-119
Orlando - Philadelphia	112-97
Boston - Washington	140-133
Houston - Clippers	102-93
Minnesota - San Antonio	129-114
Lakers - Golden State	120-94
Portland - Toronto	106-114

SHKURT

Henry, trajner i Montreal Impactit

Legjenda e Arsenalit, Thierry Henry, është emëruar trajner i skuadrës së Montreal Impact. Francezi ka qenë trajner i Monacos edicionin e kaluar, kurse me skuadrën e re që është pjesë e MLS ka nënshkruar kontratë dyvjeçare. "Është nder ta menaxhoj Montreal Impact dhe të kthehem në MLS", ka thënë Henry, i cili ka pasur një karrierë të jashtëzakonshme pasi, përveç Arsenalit, ka luajtur edhe për Monacon, Juventusin, Barcelonën dhe New York Red Bullsit.

Matthaus: Nëse rikthehet Guardiola, fiton Bundesliga

Bayern Munchen seriozisht po mendon rikthimin e trajnerit Pep Guardiolas në "Allianz Arena". Legjenda e klubit "bavarez" dhe futbollit gjerman Lothar Matthaus ka thënë se me rikthimin e strategut spanjoll në Bayern fiton e gjithë Bundesliga. "Nëse Bayerni dëshiron të luajë futboll dominues ndaj kundërshtarit, me posedim të topit, nuk ka zgjidhje më të mirë se Guardiola. Kthimi i tij do të ishte një fitore për Bayern Munich dhe për Bundesligën", ka thënë Matthaus. Aktualisht Guardiola është trajner i Manchester City.

Willian: Ronaldinho ishte më i mirë se Messi dhe Ronaldo

Ylli brazilian i Chelseat, Willian, insiston se Ronaldinho është futbollisti më i madh i epokës moderne para Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos. "Ronaldinho ishte më i miri nga të gjithë. Ai ishte më i mirë se Cristiano Ronaldo dhe Messi", ka thënë Willian. "Ata shënojnë shumë gola, por ajo që bënte Roni ishte e mahnitshme. Ai ishte i mahnitshëm në fushë dhe shënonte gola. Si tifoz i tij unë mendoj se ai u ndal shumë shpejt. Nëse Ronaldinho do të kishte vazhduar të luante edhe për një dy vjet, ai do të ishte më i miri në botë në tre, katër ose pesë raste. Ai ishte dy herë, dhe atëherë nuk e di se çfarë ndodhi. Ai ishte idhulli im më i madh në futboll", ka deklaruar Ronaldinho.

Atletico, 6 muaj pa Digo Costën

Sulmuesi i Atletico Madridit, Diego Costas, do të jetë jashtë fushës në gjashtë muajt e ardhshëm. Lajmi është bërë me dije të enjten nga mediet në Spanjë. Kjo mungesë vjen si pasojë e asaj se sulmuesi Costa vuan nga një hernie discale në qafë. Atletico Madridi ende nuk ka dalë me një komunikatë zyrtare për gjendjen e lojtarit, por shpejt duhet të marrë një vendim për zgjidhjet që mund të gjenden. E sigurt është që Diego Costa, i cili në këtë sezon ka shënuar vetëm dy gola në 15 ndeshje, do të qëndrojë jashtë fushave të futbollit për një kohë të gjatë.

Ibra i jep lamtumirën LA Galaxyt

Sulmuesi Zlatan Ibrahimović i ka dhënë lamtumirën Major League Soccerit dhe tifozëve të Los Angeles Galaxy në mënyrën më origjinale të mundshme, vetëm ashtu si ai di ta bëjë. Në një postim në "Twitter", Ibra ka shkruar: "Unë erdha, unë pashë, unë pushtova, faleminderit Los Angeles Galaxy që më të bëtë të ndihem sërish i gjallë. Për fansat e Los Angeles Galaxy: Ju donit Zlatanin, unë jua dhashë juve Zlatanin. Ju jeni të mirëpritur, historia vazhdon, tani shkoni të shikoni bejsboll". Një mbyllje e mesazhit në "Twitter", me një thumb në stilin original që karakterizon Ibrën. Edhe Los Angeles Galaxy e ka falënderuar për dy sezonet që suedezi mbajti veshur fanellën e tyre duke postuar një video në të cilën janë 52 golat që Zlatan realizoi me fanellën e skuadrës kaliforniane.

Fletëparaqitja qe nuk i kanë të kompletuara me këto dëshmi, nuk do te marrin pjesë në **konkursin (Ankand) publik**.

Çmimi fillestar ne Konkursin (Ankandin) Publikë për parcelën ndërtimore te sipër theksuar **është 21 %** (njëzet e një përlind) te vlerës apo metër katrore te ndërtimit, shumë te cilën investitori e paguan Komunës së Skenderajt..

Mënyra e pagesës se shumës se përcaktuar **prej 21 %** nga ofertuesi me i volitshëm përcaktohet me kushtet e kontratës.

AFATET KOHORE

Kohëzgjatja e konkursit (ankandit) publik për dhënjën e pronës se paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë është **15 ditë** kalendarik nga dita e publikimit sipas nenit 15 pika 1. e ligjit NR-06/L-092.

Fletëparaqitja e pjesëmarrësve mund te dorëzohen ne adrese te Komunës se Skenderajt , 41000, rruga "28 nëntori" pa numër Skenderajt apo drejtpërdrejt ne arkivin e Komunës se Skenderajt zyra numër 1.

Hapja e ofertave do te behet ne sallën e mbledhjeve te Drejtoreve ne objektin e Komunës me date **02.12.2019 e Hene duke filluar ne ora 15:00.**

PROCEDURA E KONKURSIT (Ankandit) PUBLIK

- Konkursi (Ankandi) publik mund të filloi me se paku me një pjesëmarrës (ofertues) në konkurs (Ankand).**
- Konkursin (Ankandin) publik e përcill Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës (vendimin Nr-01-020/04-0049229/19).**
- Konkursi (Ankandi) publik fillon me shpalljen e çmimit fillestar te vlerës se investimit ndërsa realizohet me konkurs publik nga pjesëmarrësit.**
- Konkursi (Ankandi) publik kryhet "hap pas hapi" me rritjen e vlerës se çmimit ne çdo "hap" nga pjesëmarrësit.**
- Konkursi (Ankandi) publik llogaritet i mbyllur ne momentin e kalimit te kohës se caktuar ne shpallje, por nëse pas kalimit te dy minutave te fundit jepet oferta nga pjesëmarrësit, atëherë afati i mbylljes zgjatet edhe për dy minuta përtej kohës se paraparë te mbyllet Konkursi (Ankandi) Publik.**
- Vazhdimi i afatit te Konkursit (Ankandit) Publik lejohet me se shumti tre here nga pesëmbëdhjetë (15) dite kalendarike nëse asnjëri nga konkurruesit (ofertuesit) nuk ka plotësuar kushtet dhe kriteret e Konkursit (Ankandit) Publik apo nëse nuk ka konkuruar asnjë person fizik ose juridik.**
- Pjesëmarrësi ne konkursin (Ankandin) publik qe ka ofruar çmimin me te larte investiv dhe vende te lira pune me shumë theksohet me procesverbal se është ofertuesi me i volitshëm për Komunën e Skenderajt.**
- Komisioni pas përfundimit te konkursit (Ankandi) Publik përgatit procesverbal me shkrim për rrjedhën e konkursit (Ankandit) Publik.**
- Kuvendi i Komunës merr vendim për miratim ne baze te raportit dhe rekomandimeve te komisionit te vlerësimit sipas vendimit Nr-01-020/04-0049229/19.**
- Kryetari i Komunës se Skenderajt nënshkruan marrëveshje (kontrate) me ofertuesin me te volitshëm për denjën ne shfrytëzim për 99 vite te tokës ndërtimore ne pronësi te Komunës së Skenderajt.**
- Ofertuesi me i volitshëm detyrohet qe ne afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit te kontratës ta dorëzoj at tek noteri e edhe ta vërtetoi ne gjykatë për solemnizimin e marrëveshjes (kontratës) ne kopje identike te mjaftueshme.**
- Ofertuesi me i volitshëm obligohet qe ne afat prej 30 ditësh pas solemnizimit te marrëveshjes (kontratës) te siguroi leje për ndërtimin e objektit te Stacionit te Autobusëve me objekte tjera përcjellës ne përputhje me planin zhvillimore komunal ne përputhshmëri me vendimin e kuvendit komunal sipas te cilit toka është dhëne ne shfrytëzim, ne te kundërtën marrëveshja (kontrata) do te anulohet.**
- Ofertuesi me i volitshëm obligohet qe te ndërtoj objektin ne përputhshmëri me kriteret e ndërtimit te cilat përcaktohen nga drejtoria komunale përkatëse (DUMA) ne një afat kohor prej 1 deri ne 2 vite nga dita e marrjes te lejes për ndërtim**
- Evidentimi dhe bartja e te drejtave te shfrytëzimit te patundshmërisë ne librat kadastra dhe procedurat ne Drejtorin përkatëse për gjeodezi, kadastër e pronësi i barte komuna pas realizimit te projektit Stacioni i Autobusëve.**
- Pjesëmarrësit te pakënaqur me konkursin (Ankandin) Publik mund te dorëzojnë kundërshtim tek komisioni i ankesave ne afat prej (3) tre ditësh nga dita e mbajtjes se konkursit (ankandit) Publik.**
- Komisioni përkatës obligohet te vendos ne afat prej (5) ditësh me aktvendim për parashtruesit e ankesës.**

Kjo shpallje do te publikohet ne dy gjuhë zyrtare

- **Ueb faqen zyrtare te Komunës së Skenderajt www.skenderaj-gov.net**
- **Në një gazet te përditshme ditore**
- **Ne te paktën dy portale informative**
- **Ne tabelën e shpalljeve dhe njoftimeve publike te Komunes së Skenderajt**

Komisioni Vlerësues

- | | | |
|----|-------------------------|-----------------------------------|
| 1. | Kryesuesi i komisionit, | <u>Ramiz Shala</u> |
| 2. | Anëtare | <u>Yanije Ahmeti Ahmeti</u> |
| 3. | Anëtar | <u>Rafizit Isufi</u> |
| 4. | Anëtar | <u>Boris Aruga</u> |
| 5. | Anëtar | <u>MILAZIM MUSTAFAS - OJQ IQS</u> |



Pejë, 14.11.2019

Me bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, UA nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenin 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës nr. 04/L-037, nenin 169, 170, 171, 172, 173, 174, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë nr. 04-V-622, Rregulloren për të Ardhurat Personale të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë ref. nr. 1944/16, e dt. 05.10.2016, Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019, Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me datë 08.11.2019, nxjerri vendim sipas të cilit:

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" në Pejë
shpall

KONKURS

për riemërimin/avancimin e personelit akademik të rregullt në UHZ

I. Konkursi për shpalljen e pozitave në vijim:

FAKULTETI I BIZNESIT

Mësimdhënës për lëndët:

1. Një mësimdhënës për lëndët: Menaxhimi i Operacioneve, Menaxhimi i Cilësisë, Bazat e Biznesit, Teknologjia Informative, Sistemet Informative, E – marketingu dhe Politikat e Rekrutimit;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Liderशिpi, Liderशिpi dhe Vendimmarja, Mjedisi Biznesor Ndërkombëtar, Ekonomia e UE – së dhe Kosova, Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore;

Asistent për lëndët:

1. Një asistent për lëndët: Mikroekonomia, Makroekonomia, Ekonometri, Analiza Mikroekonomike, Ekonomiksi i Avancuar;

II. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Riemërimi/avancimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, dispozitat e Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe Rregulloren për Procedurat Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, nr. 754, dt. 01.04.2019.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për rizgjedhje në pozitën e asistentit duhet të jenë të regjistruar në studimet e doktoratës, më saktësisht shih nenin 174, të statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

III. KUSHTET PËR APLIKIM:

1. Kandidatët të cilët aplikojnë për riemërim/avancim për mësimdhënës duhet t'i paraqesin këto dokumente: formularin e aplikimit, CV - in, vendimin për thirrjen e fundit nga UHZ, kontratën e punës valide më UHZ, dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale në 4 vitet e fundit, si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë.
2. Kandidatët të cilët aplikojnë për riemërim në pozitën e asistentit duhet t'i paraqesin këto dokumente: formularin e aplikimit, CV - in, vendimin e zgjedhjes së fundit nga UHZ, kontratën e punës valide më UHZ, vendimin për regjistrimin e studimeve të doktoratës (të noterizuar dhe përkthyer në gjuhën shqipe), si dhe si dhe informatat e tjera specifike shtesë, të cilat janë të rëndësishme për pozitën që aplikojnë.
3. Kandidatët që kanë mbaruar studimet bachelor, master ose të doktoratës jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi nga MASHT përkatësisht vendimin për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.
4. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes në web-faqen zyrtare të Universitetit dhe gazetë, respektivisht deri më 29.11.2019.
5. Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmimeve të nevojshme sipas konkursit, duhet fillimisht të dorëzohen në formë elektronike në e-mail: apliko.online@unhz.eu dhe pastaj në formë fizike në zyrën e protokollit në Rektorat nga ora 09:00-15:00. Aplikacionet e dërguara pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: <http://www.unhz.eu>



Peć . 14.11.2019

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, UA br. 07/2017 o Regulisanju Konkursne Procedure u javnom sektoru, član 26. Zakona o visokom obrazovanju na Kosovu, br. 04 / L-037, člana 169, 170, 171, 172, 173, 174, statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, br. 04-V-622, Uredbe o ličnom ohotku Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći br. Pro. 1944/16, dt. 05.10.2016, Pravilnika o Postupku Procjene za Izbor, Reizbor i Napredovanje Redovnog Akademskog osoblja na Univerzitetu " Haxhi Zeka " u Peći, i, br. 754, dt. 01.04.2019, Senat Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, na sjednici održanoj dana 08.11.2019, donio je odluku prema kojoj:

UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" Peć
objavljuje
KONKURS

za reizbor/napredovanje redovnog akademskog osoblja na UHZ

I. Konkurs se objavljuje na sledećim pozicijama:

FAKULTET BIZNESA:

Nastavnik za predmete

1. Jedan nastavnik za predmete : Operativni menadžment, Upravljanje kvalitetom, Osnove biznisa, Informaciona tehnologija, Informacioni sistemi, E- marketing, i Rekreutimit politika.
2. Jedan nastavnik za predmete : Liderstvo, Liderstvo i donošenje odluka, Međunarodno poslovno okruženje, Ekonomija EU - i Kosova, Strateško upravljanje ljudskim resursima;

Asistent za predmete:

2. Jedan asistent za predmete: Mikroekonomija, Makroekonomija, Ekonometrija , Mikroekonomska analiza, Napredna ekonomija.

II. OPŠTI USLOVI

1. Reizbor/ napredovanje akademskog osoblja vrši se u skladu sa Zakonom br. 04 / L-037 o visokom obrazovanju u Republici Kosovo, u skladu sa dispozicijama Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći, Pravilnika za Procedure vrednovanja o reizboru i unapređivanje akademskog osoblja Pro. Br. 754 dt. 01.04.2019 na Univerzitetu "Haxhi Zeka" u Peći.
2. Kandidati koji apliciraju za reizbor na poziciji Asistenta trebaju biti upisani na doktorskim studijama , tačnije na osnovu člana 174 Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peći.

III. USLOVI ZA APLICIRANJE

1. Kandidati koji se prijavljuju za reizbor/ napredovanje na poziciji nastavnika treba dostaviti sljedeće dokumente: Formular za apliciranje, CV, Resenje o zadnjem zvanju sa UHZ, Važeći ugovor o radu na UHZ, dokaz o naučnim i stručnim publikacijama u poslednje 4 godine, kao i dodatne druge informacije, koje su važne za poziciju koju se prijavljuju.
2. Kandidati koji se prijavljuju za reizbor/ napredovanje na poziciji Asistenta treba dostaviti sljedeće dokumente: Formular za apliciranje, CV, Resenje o zadnjem zvanju sa UHZ, Važeći ugovor o radu na UHZ, resenje o upisu na doktorskim studijama (ovjereno i prevedeno na albanskom jeziku), kao i dodatne druge informacije, koje su važne za poziciju koju se prijavljuju.
3. Kandidati koji su završili bachelor, master i doctorat u inostranstvu, moraju također priložiti dokaze iz MONT-a, naprotiv odluku o nostrifikaciji određene diplome, u suprotno, dosje od podnosioca će se smatrati nepotpunim.
4. Konkurs ostaje otvoren 15 (petnajest) kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj web- stranici Univerziteta i novinama, tačnije do 29.11. 2019.
5. Ispunjene aplikacije zajedno sa kopijama potrebnih dokaza na osnovu konkursa , trebaju se poslati u elektronskoj formi na e-mail: apliko.online@unhz.eu a onda i predati u kancelariji protokola u Rektoratu od 09:00-15:00 h. Aplikacije poslane posle roka kao i one nekompletne neće se razmatrati.

Konkurs možete pronaći objavljen i na web stranici na adresi: <http://www.unhz.eu>

REPUBLIC OF KOSOVA

**MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT (MED)
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY AGENCY (KEEA)
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY & RENEWABLE ENERGY PROJECT (KEEREP)**
**REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST FOR:
IMPLEMENTATION OF HOME OWNER ASSOCIATIONS (HOAs)**
Project no ID **P143055**Ref. No. **KEEREP/2B3/2019**DATE: **NOVEMBER 15, 2019****INTRODUCTION**

The Republic of Kosovo has received the financing from the World Bank toward the cost of the Kosovo Energy Efficiency and Renewable Energy Project (KEEREP) and it intends to apply part of the proceeds to payments for Consulting Services. The consulting services include consulting services for the Implementation of Home Owner Associations (HOAs).

The Ministry of Economic Development (MED) and Kosovo Energy Efficiency Agency (KEEA), for and on behalf of the Ministry of Environment and Spatial Planning (MESP), now invites eligible consulting firms ("Consultants") to indicate their interest in providing the services. Interested consultants must provide information indicating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the services.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants [under IBRD Loans and IDA Credits & Grants] by World Bank Borrowers, January 2011 ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms in the form of a joint venture or a sub consultancy to enhance their qualifications.

DESCRIPTION OF THE ASSIGNMENT

Under component 2 of the project, MESP has supported a pilot program to promote formation of HOAs to facilitate energy efficiency (EE) renovations in multifamily apartment buildings. Nine HOAs in three municipalities (Pristina, Mitrovica and Lipjan) have been created, which almost doubled the number of registered HOAs in Kosovo. For all nine HOAs, energy audits were completed and financing plans for the EE measures developed. In five out of the nine HOAs, the owners agreed to provide co-financing for the EE measures and detailed design and bidding documents were developed. The pilot program should now be scaled-up to establish additional HOAs and develop energy audits, financing plans and detailed designs for EE renovations, which would feed into the Millennium Foundation Kosovo (MFK) residential EE program. MFK is the implementing entity of the Kosovo Threshold Program agreed between the Government of the Republic of Kosovo and Millennium Challenge Corporation (MCC). The Kosovo Threshold Program aims to address two key constraints to Kosovo's economic growth: Unreliable supply of electricity; and real and perceived weakness in rule of law, government accountability and transparency. One of the objectives of this program, under the Reliable Energy Landscape component, is to pilot methods to lower household energy use and switch to non-electric and cleaner sources of heating through various types of incentives and modalities to encourage households to invest in cost-effective, energy saving measures (e.g. insulation, weatherproofing, etc.). Through cooperation with MFK, the pilot program to promote formation of HOAs and implement EE measures in multifamily apartment buildings will be scaled up.

ACTIVITIES TO BE UNDERTAKEN

The consulting firm will support MED and MESP in scaling up of the pilot program to establish additional HOAs and develop additional energy audits, financing plans and detailed designs for EE renovations. This includes the following activities:

- **Select multifamily apartment buildings in three municipalities with signed Memorandum of Understanding (MOUs) with MESP**, through a call for proposals and selection criteria to participate in the program.
- **Support formation of HOAs**: Buildings that do not have registered HOAs will receive support to help form and register their HOA.
- **Conduct energy audits** and assist the HOAs with preparation of financing plans for the selected EE measures
- **Develop detailed designs** for the EE measures in the buildings.

The Consultant should be a consulting firm with relevant project experience. The work should be undertaken by a consulting team consisting of experts who have skills and credentials to perform the work.

The work should be undertaken by a consulting team consisting of experts with the following expertise:

- **Team leader**: Master's degree or higher in public administration or related fields. Not less than 5 years of experience in HOAs or community mobilization.
- **Legal expert**: Master's degree or higher in law. More than 5 years of professional experience, particularly in developing legislation related to municipal administration, HOAs or condominium laws.
- **Energy efficiency expert**: Master's degree or higher in engineering (electrical, mechanical, civil or architect). More than 8 years of professional experience in energy efficiency and conducting energy audit reports, including in multifamily apartment buildings in Eastern Europe.
- **Civil engineer**: Master's degree or higher in civil engineering. More than 5 years of professional experience in preparation of detailed project designs and technical specification, including BOQs, for building renovations with emphasis on energy efficiency.
- **Financial expert**: Master's degree or higher in finance or related fields. Not less than 5 years of professional experience in financial aspects regarding investments on construction/renovation and experience in providing/applying for loans from banks for municipal or private borrowers.
- **Community mobilizing specialist**: Bachelor's degree or higher in municipal administration, community development or related field with not less than 5 years' experience in mobilizing communities for development programs, stakeholder consultations, building consensus, and/or HOA formation.

The evaluation and shortlisting criteria are:

- Firms experience in architecture, engineering, supervision and project designing (30%);
- Relevant work experience in implementing similar projects (50%) and
- Organization and availability of qualified staff with the firm (20%).

A consultant will be selected in accordance with the Consultants Qualification Selection (CQS) set out in the Consultant's Guidelines.

Interested consultants may obtain further information at the address below during office hours 09:00h to 16:00h (Monday to Friday).

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below by **November 29, 2019 at 16:00** hours Kosovo time.

The Government of the Republic of Kosovo
Ministry of Economic Development (MED)
Kosovo Energy Efficiency Agency (KEEA)
Kosovo Energy Efficiency and Renewable Energy Project (KEEREP)
Office no.107 (1 floor)
Mother Theresa Str. no.36
10 000 Prishtina - Kosovo.

Attn: Mr. Luan Asllani
Procurement Specialist – MED-KODE/PIU
Ph.: +383 38 200 21 563
E-mail address: Luan.Asllani@rks-gov.net

Njoftim për shprehje të interesitEmri i shkollës: **"Idriz Barani"**Komuna: **Skenderaj**Data: **15.11.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/113-CS/1.3	Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **"Idriz Barani" Klinë e Epërme, Skenderaj**.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkollë.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsosjen e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatesisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën **"Idriz Barani" Klinë e Epërme, Skenderaj, më së largu deri më datën; 25.11.2019**

Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:Personi kontaktues: **Shefqert Avdiu**Telefoni: **044/482609**E-maili: **"shefqet2010@live.com"****>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Ibadete Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë diplomën Bachelor dhe Master.

► Islam Meliqi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ilaz Thaqi" Hani Elezit.

► Ilirjana Pajaziti nga Peja shpall të pavlefshme dëftesat e gjimnazit ish "Ivo Lolla Ribar" - tash "Sami Frashëri", viti i parë dhe viti i dytë i vitit 1978\79 dhe 1979\80.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 31.10.2019 për shpalljen e konkursit , gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 14.11.2019 të shpallë:

**KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të punës:**

Vozitës i kategorisë "C" me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Vozitës i kategorisë "C" – Njësia në Mitrovicë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullsinë, higjienën dhe pastërtin e tij.
- Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikasë dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.
- Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,-para daljes në terren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencen punët e kryera , vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njëjtën e kthen te dispečeri.
- Vendos (monton) letren e re të tahografit ndërsa letren paraprake e kthen te dispečeri, brenda 12 orëve.
- Vozitësi i cili e monton letren e tahografit ka obligim që në të të shenon: Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare.
- Është i obliguar që në automjet të ketë mjeket e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon.largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhërësën e punës -në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në terren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomistërin.
- Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtëpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes -qdo sjellje të pandërgjegjshme të punëtorëve me të cilët punon vozitësi është i obliguar që ta paraqet te udhëheqësi i drejtëpërdrejt-kryepunëtorit e njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim.
- Është i obliguar që në Deponi të mbeturinave të përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi.
- Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër , dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, të drejtëpërdrejt nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme
- Vozitës i kategorisë "C"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. Mund të dorëzohen në Zyren e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 14.11.2019 deri më datën 29.11.2019. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit me Nr.21 për Ri-shpalljen e konkurseve, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që më datë 14.11.2019 të rishpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës:

Punëtor Fizik me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi 2-Punëtor fizik - Njësia në Mitrovicë

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor,
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi.
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve.
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit,
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve.
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë së paku një vit përvojë pune
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj)

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 14.11.2019 deri më datën 29.11.2019. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 23.10.2019 për Ri-shpalljen e konkursit , gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 14.11.2019 të rishpallë:

**KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të punës:**

Vozitës me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Vozitës – Njësia në Mitrovicë

1.Vozitës

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Drejton veturën zyrtare, kujdeset për rregullsinë teknike dhe është përgjegjës për vozitje të sigurtë.
- Kujdeset për higjienën dhe pastërtinë e veturës, mban evidencën e punës dhe shpenzimeve.
- Është përgjegjës për parkim të rregullt të veturës dhe për hargjimin e drejtë dhe racional të karburantëve dhe vajit.
- Kryen edhe punë tjera të kësaj natyre të cilat i përcaktonë sipas urdhërësës eprori i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet

- Të ketë diplomën e shkollës fillore ose të mesme
- Vozitës i kategorisë "B"
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat, etj. Mund të dorëzohen në Zyren e Arkivës në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 14.11.2019 deri më datën 29.11.2019. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 31.10.2019 për shpalljen e konkursit , dhe gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 14.11.2019 të shpallë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Arkatar/e me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare) , me mundësi vazhdimi

Arkatar/e -në Vushtrri

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Mbajtja dhe përgjegjësia për arkën, pranimi i të hollave të gatshme dhe dorëzimi i tyre në bankat kompentente.
- Pagesa dhe inkasimi përmes arkës, ngarkesat dhe shkarkesat e inkasantve me fatura çdo ditë dhe kur ka nevojë.
- Mbajtja dhe përfundimi i përditshëm i ditarit të arkës dhe regjistrimi të tij në kontabilitet.
- Përgjegjësia materiale ,penale dhe rregullësia në punë për mjetet monetare dhe tjera me të cilat është ngarkuar.
- Kujdesi për sigurinë me rastin e marrjes dhe bartjes së hollave dhe letrave me vlerë, si dhe punët tjera sipas urdhërësës së eprorit të drejtëpërdrejtë apo personit që e cakton ai.
- Përgjegjësia për zbatimin nga eprori i drejtëpërdrejtë, si dhe punë tjera të kësaj natyre të cilat i përcaktonë eprori.

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës së mesme
- Të prezantoj leternjoftimin
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti"Sh.A.Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 14.11.2019 deri më datën 29.11.2019. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.